



**GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË  
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

**PRISHTINË**  
.....  
VITI I / Nr.3 / 1 GUSHT 2006

## GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË

Editon: Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, botohet në mbështetje të *Ligjit për Gazetën Zyrtare nr. 2004/47*; si dhe *Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/25 për shpalljen e Ligjit për Gazetën Zyrtare*.

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë boton tekstet zyrtare dhe përfundimtare të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm; rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, rregullativat dhe aktet e tjera normative të Qeverisë dhe ministrive; marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar etj.

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, botohet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, angleze, serbe, turke dhe atë boshnjake.

U.d. Drejtor i Gazetës Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë:  
**Naser Canolli**

Redaktor përgjegjës:  
**Arben Veselaj**

Adresa dhe korrespondencat:  
Ndërtesa e re e Qeverisë,  
Prishtinë  
gazetazyrtare@ks-gov.net  
038-201 14039  
www.ks-gov.net/gazetazyrtare

NË RAST MOSMARRËVESHJEJE NDËRMJET VERSIONEVE TË DOKUMENTEVE TË  
NDRYSHME TË SHPALLURA NË GAZETËN ZYRTARE TË IPVQ-VE TË KOSOVËS,  
VERSIONET NË GJUHËT ZYRTARE TË QEVERISË, NË PËRPTHJE  
ME PARAGRAFIN 9.3.19 TË KORNIZËS KUSHTETUESE, JANË NJËSOJ AUTENTIKE



## **PËRMBAJTJA**

<i>LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS .....</i>	<i>1</i>
<i>LIGJI PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË .....</i>	<i>28</i>
<i>LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR.....</i>	<i>37</i>



# Ligji Nr. 2004 / 26 LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

## PJESA E PARË

### KREU I PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### OBJEKTI I LIGJIT TË TRASHËGIMISË

##### Neni 1

1.1. Me këtë Ligj rregullohet e drejta e trashëgimisë.

1.2. Trashëgimia është kalimi me Ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara në këtë Ligj.

1.3. Me këtë Ligj rregullohen procedurat në bazë të të cilave gjykata, organet tjera dhe personat tjerë të autorizuar duhet të veprojnë në çështjet trashëgimore

1.4. Në kuptim të këtij Ligji emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas pa diskriminim.

#### OBJEKTI I TRASHËGIMIT

##### Neni 2

Mund të trashëgohen sendet dhe të drejtat të cilat i përkasin individëve.

#### BARAZIA NË TRASHËGIMI

##### Neni 3

3.1. Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi.

3.2. Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia

është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim.

3.3. I adoptuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë.

3.4. Të huajt janë të barabartë në trashëgimi me kosovarët, me kusht reciprociteti. Reciprociteti prezumohet.

#### FITIMI I TRASHËGIMIT

##### Neni 4

4.1. Trashëgohet për shkak të vdekjes dhe në momentin e vdekjes së personit fizik.

4.2. Mund të trashëgohet secili person fizik.

#### KOHA DHE VENDI I HAPJES SË TRASHËGIMIT

##### Neni 5

5.1. Personin e vdekur fizik (trashëgimlënësin) e trashëgon ai i cili në momentin e vdekjes së tij ka fituar të drejtën trashëgimore (trashëguesi).

5.2. Secili person është i aftë për të trashëguar, po që se me ligj nuk është paraparë ndryshe.

5.3. E drejta në trashëgimi fitohet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Fituesi i të drejtës në trashëgimi mund të heqë dorë nga kjo e drejtë sipas dispozitave të këtij ligji, me ç'rast do të merret se këtë të drejtë asnjëherë nuk e ka fituar.

#### MARRËVESHJET PËR TRASHËGIMINË E ARDHSHME

##### Neni 6

Është e pavlefshme çdo marrëveshje mes trashëgimtarëve të ardhshëm, ose mes trashëgimtarëve të ardhshëm dhe personave të tretë, lidhur me një trashëgimi ende të pahapur.

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

**ZOTËSIA PËR TË TRASHËGUAR**

**Neni 7**

7.1. Personi që në kohën e hapjes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë, ka zotësi për të trashëguar.

7.2. Konsiderohet se ka qenë zënë në kohën e hapjes së trashëgimisë, ai person që ka lindur i gjallë brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.

**BAZAT PËR THIRRJEN NË TRASHËGIMI**

**Neni 8**

Trashëgimia fitohet me ligj ose testament.

**TRASHËGIMIA LIGJORE NË PËRGJITHËSI**

**Neni 9**

Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

**DISPONIMET NË RAST VDEKJE  
(MORTIS CAUSA)**

**Neni 10**

Kur trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtar, e drejta për të trashëguar kalon në komunë, e cila fiton pozitë të njejtë sikurse me qenë trashëgimtar i trashëgimlënësit dhe kjo nuk mund të heqë dorë nga trashëgimia.

**KREU I DYTË  
TRASHËGIMIA ME LIGJ**

**TRASHËGIMTARËT LIGJORË**

**Neni 11**

11.1. Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.

11.2. Me ligj trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti i tij jashtëmartesor, i cili barazohet me bashkëshortin martesor. Bashkësi jashtëmartesore në kuptim të këtij Ligji konsiderohet bashkësia jetësore e gruas së pamartuar dhe e burrit të pamartuar e cila ka zgjatur një kohë të gjatë dhe që ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, me kusht të kenë qenë plotësuar prezumimet për vlefshmërinë e martesës.

11.3. Këta persona thirren në trashëgim sipas radhës së caktuar në këtë Ligj.

11.4. Trashëgimtarët e radhës më të afërt të trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët.

**I - RADHËT E TRASHËGIMISË  
1. - RADHA E PARË E TRASHËGIMISË**

**PASARDHËSIT DHE BASHKËSHORTI I  
TRASHËGIMLËNËSIT**

**Neni 12**

12.1. Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij.

12.2. Personat nga paragrafi (1) i këtij Neni trashëgojnë në pjesë të barabarta.

**E DREJTA E PËRFAQËSIMIT**

**Neni 13**

13.1. Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me



zëvendësim fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapara me Ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim.

13.2. Personat nga paragrafi (1) i këtij Neni trashëgojnë në pjesë të barabarta.

## 2. - RADHA E DYTË E TRASHËGIMISË

### PRINDËRIT DHE BASHKËSHORTI I TRASHËGIMLËNËSIT

#### Neni 14

14.1. Pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij.

14.2. Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit.

14.3. Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort, prindërit e trashëgimlënësit e trashëgojnë tërë pasurinë në pjesë të barabarta.

14.4. Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij, bashkëshorti trashëgon tërë pasurinë.

### VËLLEZËRIT DHE MOTRAT E TRASHËGIMLËNËSIT DHE PASARDHËSIT E TYRE

#### Neni 15

15.1. Në qoftë se njëri nga prindët e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitave të këtij Ligji që vlejné për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij.

15.2. Në qoftë se të dy prindët e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë pasardhësit përkatës, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

15.3. Në të gjitha rastet vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit vetëm nga ana e atit trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e pasurisë trashëgimore të atit, vëllezërit dhe motrat vetëm nga ana e nënës trashëgojnë në pjesë të barabarta vetëm pjesën e nënës, kurse vëllezërit dhe motrat të së njëjtës nënë dhe të të njëjtit at trashëgojnë në pjesë të barabarta me vëllezërit dhe motrat nga ana e të atit, kurse me vëllezërit dhe motrat nga ana e nënës pjesën e nënës.

### TRASHËGIMI I NJË PRINDI QË KA VDEKUR PA PASARDHËS

#### Neni 16

Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, e nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgon prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e tij trashëgojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte të dy prindërve, sipas Neni 15 të këtij Ligji.

## 3. - RADHA E TRETË E TRASHËGIMTARËVE

### TRASHËGIMI I PRINDËRVE QË KANË VDEKUR PA PASARDHËS

#### Neni 17

Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit e nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit.

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

**GJYSHËRIT DHE GJYSHET  
E TRASHËGIMLËNËSIT**

**Neni 18**

18.1. Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort prindër dhe prindërit e tij nuk kanë lënë pasardhës të tjerë, e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij.

18.2. Gjysmën e pasurisë trashëgimore e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e atit, kurse gjysmën tjetër gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës.

**TË DREJTAT E GJYSHIT DHE TË GJYSHES TË  
TË NJËJTIT TRUNG**

**Neni 19**

19.1. Gjyshi dhe gjyshja të të njëjtit trung trashëgojnë në pjesë të barabarta.

19.2. Në qoftë se ndonjë nga parardhësit e të njëjtit trung ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij sipas rregullave që aplikohen për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë prindërit e dhe vëllezërit e motrat e tij.

19.3. Për çdo gjë tjetër lidhur me të drejtën trashëgimore të gjyshit dhe të gjyshes të të njëjtit trung dhe të pasardhësve të tyre zbatohen dispozitat sipas të cilave trashëgimlënësin e trashëgojnë prindërit e dhe vëllezërit e motrat e tij.

**TRASHËGIMI I GJYSHIT DHE I GJYSHES TË  
TË NJËJTIT TRUNG TË CILËT KANË VDEKUR  
PA PASARADHËS**

**Neni 20**

Në qoftë se gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë gjyshi dhe

gjyshja e trungut tjetër, sikurse është caktuar në Nenin 19 të këtij Ligji.

**1. TRASHËGIMI NGA ANA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE**

**KOMUNA SI TRASHËGIMTAR LIGJOR I  
RADHËS SË FUNDIT**

**Neni 21**

21.1. Nëse trashëgimlënësi nuk lënë as trashëgimtarë ligjor dhe as testament, konsiderohet se trashgëmia i takon komunës ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin ose vendqendrimin e tij të fundit.

21.2. Nëse ky vendbanim ose vendqendrim ka qënë jashtë Kosovës, atëherë pasuria trashëgimore konsiderohet se i takon Komunës ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanim ose vendqendrim e tij të fundit në Kosovë dhe nëse nuk ka pasur kurrë këtë, pasuria trashëgimore i takon Kosovës.

**II - DISPOZITA TË VEÇANTA PËR DISA  
TRASHËGIMTARË**

**1. - FËMIJËT**

**TRAJTIMI I BARABARTË I FËMIJËVE TË  
TRASHËGIMTARIT**

**Neni 22**

Fëmijët e lindur në martesë, jashtë martesë, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, si dhe ata të adoptuar dhe pasardhësit e tyre kanë të drejta të barabarta në trashëgimi.

**SHTIMI I PJESES TRASHËGIMORE  
TË FËMIJËVE**

**Neni 23**

Kur ekziston fëmija i trashëgimlënësit, prindi tjetër i të cilit nuk është bashkëshort pas-

jetues, e pasuria e bashkëshortit pasjetues është më e madhe se pjesa që do t'i takonte me rastin e ndarjes së pasurisë trashëgimore në pjesë të barabarta, atëherë secilit fëmijë të trashëgimlënësit i takon pjesa dy herë më e madhe sesa bashkëshortit, nëse gjykata, pasi të marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, nuk vendos ndryshe.

## 2. - TË ADOPTUARIT DHE ADOPTUESIT

### BARAZIA NË TRASHËGIMI

#### Neni 24

I adoptuari dhe pasardhësit e tij ndaj adoptuesit kanë të drejta të njëjta trashëgimore sikurse fëmijët e adoptuesit dhe pasardhësit e tjerë të tij.

### PASOJAT E KËRKESËS PËR PUSHIMIN E ADOPTIMIT

#### Neni 25

I adoptuari dhe pasardhësit e tij nuk e trashëgojnë adoptuesin, në qoftë se adoptuesi ka paraqitur kërkesë për pushimin e adoptimit, kurse pas vdekjes së tij vërtetohet se kërkesa e tij ka pasur mbështetje (ligjore).

## 3. - TË DREJTAT E BASHKËSHORTIT

### REGJIMI I PASURISË BASHKËSHORTORE

#### Neni 26

26.1. Bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës.

26.2. Nëse trashëgimlënësi dhe bashkëshorti i tij kanë pasur pasuri të përbashkët sipas regjimit të tyre të pasurisë bashkëshortore, vetëm pjesa që i takon trashëgimlënësit pas ndarjes së pasurisë së përbashkët bëhet objekt i trashëgimisë.

26.3. Asgjë në këtë ligj nuk do të interpretohet në frymën e kufizimit të së drejtës së bashkëshortit pasjetues për çkado që atij i takon sipas dispozitave të Ligjit të Familjes në lidhje me mbarimin e regjimit të pasurisë bashkëshortore.

### KUR BASHKËSHORTI NUK KA TË DREJTË PËR TË TRASHËGUAR

#### Neni 27

27.1. E drejta e trashëgimit midis bashkëshortëve pushon me shkurorizimin ose me nulimin e martesës.

27.2. Bashkëshorti nuk ka të drejtë të trashëgojë:

a. Në qoftë se trashëgimlënësi ka paraqitur padi shkurorëzimi, kurse pas vdekjes së trashëgimlënësit është bërë shkurorëzimi me aktgjykim të formës së prerë;

b. Në qoftë se martesa e tij me trashëgimlënësin anulohet me aktgjykim të formës së prerë pas vdekjes së trashëgimlënësit për shkak që bashkëshorti pasjetues i ka ditur në kohën e lidhjes së martesës;

c. Në qoftë se bashkëjetesa e tij me trashëgimlënësin ka pushuar me fajin e bashkëshortit pasjetues, ose në bazë të marrëveshjes me shkrim me trashëgimlënësin.

## 4. - PERSONAT QË JETOJNË NË BASHKËSINË JASHTËMARTESORE

#### Neni 28

28.1. Burri dhe gruaja që bashkëjetojnë në një bashkësi jashtëmartesore mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, nëse:

a. Bashkësia jashtëmartesore deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka zgjatur të paktën 10 vjet, e nëse nga kjo marrdhënie kanë lindur fëmijë-të paktën 5 vjet dhe,

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

b. Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit as njëri nga personat që kanë bashkëjetuar të mos ketë qënë ligjërisht i martuar me ndonjë person të tretë, ose nëse trashëgimlënësi ka qënë ligjërisht i martuar me personin e tretë, ka paraqitur padi për shkurorëzimin ose nulimin e martesës dhe pas vdekjes së tij konstatohet se padia ka pasur mbështetje.

28.2. Personat që kanë bashkëjetuar nuk konsiderohen si trashëgimtar të domosdoshëm.

28.3. Personi që ka bashkëjetuar nuk ka të drejtën e trashëgimit nëse çifti nuk ka jetur për një kohë të gjatë së bashku.

## 5. PERSONAT QË PËRFITOJNË NGA DETYRIMI PËR USHQIM OSE MBAJTJA

### TË DREJTAT E PERSONAVE NDAJ TË CILËVE TRASHËGIMLËNËSI KA PAGUAR DETYRIMIN PËR USHQIM OSE MBAJTJEN

#### Neni 29

29.1. Çdo detyrim i trashëgimlënësit për të dhënë ushqimin ose mbajtjen transferohet tek trashëgimia si borxh, nëse personi që përfiton nga ushqimi ose mbajtja nuk i ka mjetet e nevojshme për jetesë.

29.2. Trashëgimtarët ose legatarët janë përgjegjës për pagimin e këtij borxhi sipas dispozitave që rregullojnë përgjegjësinë e kreditorëve të trashëgimlënësit në përgjithësi.

III. Trashëgimtarët e domosdoshëm

### TRASHËGIMTARËT E DOMOSDOSHËM NË PËRGJITHËSI

#### Neni 30

30.1. Trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij.

30.2. Gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit janë trashëgim-

tarë të domosdoshëm vetëm në qoftë se janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë.

30.3. Personat e cekur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni janë trashëgimtarë të domosdoshëm kur sipas radhës ligjore të trashëgimit janë thirrur për trashëgim.

## PJESA E DOMOSDOSHME DHE DISPONIBILE E PASURISË TRASHËGIMORE

### Neni 31

31.1. Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet pjesë e domosdoshme.

31.2. Pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe bashkëshortit përbën një të dytën, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë një të tretën e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimit.

## 1. - LLOGARITJA E PJESËS SË DOMOSDOSHME

### PËRCAKTIMI I VLERËS SË PASURISË TRASHËGIMORE

#### Neni 32

32.1. Vlera e pasurisë trashëgimore në bazë të së cilës llogaritet pjesa e domosdoshme llogaritet në këtë mënyrë:

32.2. Së pari, inventarizohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes, duke llogaritur këtu të gjitha ato që ka disponuar me testament, si dhe të gjitha borxhet që ia kanë të tjerët, edhe ato që ia ka ndonjë trashëgimtar, me përjashtim të borxheve që qartazi që nuk mund të arkëtohen .

32.3. Nga vlera e përcaktur e të mirave që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes

zbritet shuma e borxheve të tij, shuma e shpenzimeve të inventarizimit e të vlerësimit të pasurisë trashëgimore dhe e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit.

32.4. Pjesës që mbetet i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi ka bërë në çfarëdolloj mënyre ndaj ndonjë trashëgimtari ligjor, madje edhe e dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimi, si dhe e atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore.

32.5. Kësaj shume i shtohet edhe vlera e dhurimeve që trashëgimtari në vitin e fundit të jetës së tij u ka bërë personave të tjerë që nuk janë trashëgimtarë ligjorë, me përjashtim të dhurimeve të rëndomta.

## ÇFARË KONSIDEROHET DHURIM

### Neni 33

Në kuptim të këtij Ligji “dhurim” konsiderohet çdo heqje dorë nga një e drejtë, falja e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore, ose për të themeluar apo për të zgjeruar familjen, ose për të ushtruar mjeshtërinë, si dhe çdo disponim tjetër pa shpërblim.

## CAKTIMI I VLERËS SË DHURIMIT

### Neni 34

Për vlerësimin e dhurimit merret vlera e sendit të dhuruar në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, e sipas gjendjes së tij në kohën e dhurimit të bërë.

## DHURIMI NË FORMË TË SIGURIMIT

### Neni 35

Kur dhurimi përbëhet nga sigurimi në dobi të dhuratëmarrësit, si vlerë e dhurimit merret shuma e premive që ka paguar trashëgimlënësi, nëse kjo shumë është e barabartë ose më e vogël se shuma e siguruar; e nëse shuma e

premise është më e madhe se shuma e siguruar, si vlerë e dhurimit merret shuma e siguruar.

## 2. PASURIA QË VEÇOHET NGA PASURIA TRASHËGIMORE

### VEÇIMI NË DOBI TË PASARDHËSVE QË KANË PUNUAR ME TRASHËGIMLËNËSIN

#### Neni 36

36.1. Pasardhësit e trashëgimlënësit që kanë bashkëjetuar me të, dhe që me punën, fitimin e vet ose në ndonjë mënyrë tjetër i kanë ndihmuar në punë, kanë të drejtë të kërkojnë që nga pasuria të veçohet pjesa që i përgjigjet kontributit të tyre për shtimin e vlerës së saj, po qe se nuk e kanë bërë këtë më parë.

36.2. Pjesa e veçuar në këtë mënyrë nuk i takon pasurisë trashëgimore, prandaj nuk merret parasysh në rastin e llogaritjes së pjesës së domosdoshme dhe as nuk llogaritet në pjesën trashëgimore të trashëgimtarit.

36.3. E drejta nga paragrafi 1 i këtij Neni realizohet vetëm me kërkesën e autorizuesit. E drejta në paraqitjen e kërkesës pushon 5 vjet nga dita e hapjes së trashëgimit.

### VEÇIMI I SENDEVE TË SHTËPISË

#### Neni 37

37.1. Bashkëshortit pasjetues dhe pasardhësve të trashëgimlënësit që kanë bashkëjetuar me të njëjtën familje u takojnë sendet e shtëpisë që shërbejnë për plotësimin e nevojave të tyre të përditshme, siç janë orenditë, mobiljet, etj., por jo edhe atëherë kur këto sende kanë vlerë të madhe.

37.2. Sendet e veçuara në këtë mënyrë nuk merren parasysh me rastin e llogaritjes së pjesës së domosdoshme, as që i llogariten trashëgimlënësit në pjesën trashëgimore të tij.

37.3. Personat nga paragrafi 1 i këtij Neni fitojnë të drejtën e bashkëpronësisë në pjesë të barabarta mbi sendet shtëpiake të veçuara.

### **3. ZVOGËLIMI I DISPONIMIT ME TESTAMENT DHE KTHIMI I DHURIMIT PËR SHKAK TË CËNIMIT TË PJESËS SË DOMOSDOSHME**

#### **CENIMET E PJESËS SË DOMOSDOSHME**

##### **Neni 38**

38.1. Kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme.

38.2. Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij.

#### **RADHA E ZVOGËLIMIT DHE E KTHIMIT**

##### **Neni 39**

39.1. Kur cenohet pjesa e domosdoshme, më parë zvogëlohen disponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyrë, atëherë kthehen dhurimet.

39.2. Nëse dhurata nuk mund të kthehet si send (in rem), personi që ka marrë dhuratën duhet të kthejë vlerën e saj sipas dispozitave mbi kthimin në rast të pasurimit pa bazë.

#### **ZVOGËLIMI PROPORCIONAL I DISPONIMEVE ME TESTAMENT**

##### **Neni 40**

Disponimet me testament zvogëlohen në të njëjtën masë, pa marrë parasysh natyrën e tyre dhe vëllimin e tyre dhe pa marrë parasysh gjendjen në një ose më shumë testamente, po qe se nga testamenti nuk del diçka tjetër.

#### **LEGU I PRIVILEGJUAR**

##### **Neni 41**

Në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë disa legë dhe ka urdhëruar që ndonjë leg të paguhet para të tjerëve, ky leg do të zvogëlohet vetëm nëse vlera e legëve të tjerë nuk mjafton për t'u plotësuar pjesa e domosdoshme.

#### **ZVOGËLIMI PROPORCIONAL I LEGËVE**

##### **Neni 42**

42.1. Trashëgimtari me testament, pjesa trashëgimore e të cilit duhet të zvogëlohet për t'u plotësuar pjesa e domosdoshme, mund të kërkojë zvogëlimin proporcional të legëve që ai duhet t'i paguajë, po qe se nga testamenti nuk del diçka tjetër.

42.2. Dispozita nga paragrafi 1 i këtij Neni vlen edhe për legatarin të cilin trashëgimlënësi e ka urdhëruar të paguajë diçka nga legu i vet.

#### **RADHA E KTHIMIT TË DHURIMEVE**

##### **Neni 43**

43.1. Kthimi i dhurimeve bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdon në të kundërtën me radhë tek dhurimet më të hershme .

43.2. Dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit.

#### **POZITA E DHURATËMARRËSIT QË KTHEN DHURIMIN**

##### **Neni 44**

Sa i përket sendit të dhuruar që është i detyruar ta kthejë, dhuratëmarrësi konsiderohet si mbajtës me mirëbesim deri në ditën që ka marrë dijëni për kërkesën që të kthejë dhurimin.

E drejta e kërkesës për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve

**Neni 45**

45.1. Zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve me të cilat është cënuar pjesa e domosdoshme mund ta kërkojnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshëm.

45.2. Kjo e drejtë nuk mund të cënohet nga kreditorët e trashëgimtarit të domosdoshëm

**PARASHKRIMI I KËRKESËS****Neni 46**

Zvogëlimi i disponimeve me testament mund të kërkohet brenda afatit prej tri vitësh nga shpallja e testamentit dhe kthimi i dhurimeve brenda afatit prej tri vitësh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij.

**IV - LLOGARITJA E DHURIMEVE DHE E LEGËVE NË PJESËN TRASHËGIMORE****LLOGARITJA E DHURIMEVE TRASHËGIMTARIT LIGJOR****Neni 47**

47.1. Çdo trashëgimtar i ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi në çfarëdo mënyre.

47.2. Frytet ose përfitimet e tjera që ka pasur trashëgimtarit nga sendi i dhuruar deri në vdekjen e trashëgimlënësit nuk llogariten.

47.3. Dhurimi nuk llogaritet, nëqoftëse trashëgimlënësi ka deklaruar në kohën e dhurimit ose më vonë ose në testament, se dhurimi nuk do të llogaritet në pjesën trashëgimore ose nga rrethanat mund të konkludohet se ky ka qenë vullneti i trashëgimlënësit.

47.4. Ky nen nuk cënon dispozitat për pjesën e domosdoshme.

**LLOGARITJA E LEGUT TRASHËGIMTARËVE LIGJORË****Neni 48**

Legu që i është lënë trashëgimtarit ligjor llogaritet në pjesën trashëgimore të tij, përveç nëse nga testamenti del se trashëgimlënësi ka dashur që trashëgimtarit të marrë legun përpos pjesës së tij trashëgimore.

**SI BËHET LLOGARITJA E DHURIMEVE DHE E LEGËVE****Neni 49**

49.1. Llogaritja e dhurimeve dhe e legëve bëhet në atë mënyrë që trashëgimtarët e tjerë marrin nga pasuria trashëgimore vlerën përkatëse dhe pastaj ajo që mbetet nga pasuria trashëgimore ndahet midis të gjithë trashëgimtarëve.

49.2. Në qoftë se sendet dhe të drejtat që ka pasur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk mjaftojnë që trashëgimtarët e tjerë të marrin vlerën përkatëse, trashëgimtarit në dobi të të cilit bëhet llogaritja nuk është i detyruar t'u kthejë diçka nga ajo që ka marrë.

49.3. Ky Nen nuk cënon dispozitat për pjesën e domosdoshme.

**E DREJTA E TRASHËGIMTARIT TË CILIT NUK I LLOGARITET DHURIMI OSE LEGU****Neni 50**

50.1. Kur sipas vullnetit të trashëgimlënësit dhurimi ose legu nuk duhet t'i llogaritet trashëgimtarit në pjesën trashëgimore të tij, trashëgimtarit i këtu mban dhurimin respektivisht legun dhe merr pjesë me trashëgimtarët e tjerë në ndarjen e pasurisë trashëgimore sikur të mos kishte marrë fare dhurim ose leg.

50.2. Kur ka trashëgimtarë të domosdoshëm dhe sipas vullnetit të trashëgimlënësit dhurimi ose legu nuk duhet t'i llogaritet ndonjë trashëgimtarit në pjesën trashëgimore të tij, ky trashëgimtar do të mund të mbajë dhurimin

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

përkatësisht legun brenda kufijëve të pjesës së domosdoshme.

**E DREJTA E TRASHËGIMTARIT QË KA HEQUR DORË NGA TRASHËGIMI**

**Neni 51**

Trashëgimtari që ka hequr dorë nga trashëgimi e mban dhurimin brenda kufijëve të pjesës së domosdoshme.

**E DREJTA E KTHIMIT TË DHURIMIT**

**Neni 52**

52.1. Trashëgimtari ka të drejtë të kthejë në pasurinë trashëgimore sendin që i është dhuruar.

52.2. Në këtë rast vlera e tij nuk do t'i llogaritet në pjesën trashëgimore dhe sa i përket shpenzimeve që ka bërë për sendin dhe dëmtimeve që ka pësuar sendi, ai do të konsiderohet posedues me mirëbesim, përderisa të mos provohet e kundërta .

**SHPENZIMET E MBAJTJES SË TRASHËGIMTARIT**

**Neni 53**

53.1. Ajo që është shpenzuar për mbajtjen e trashëgimtarit dhe për shkollimin e detyrueshëm të tij nuk do të llogaritet në pjesën trashëgimore të tij.

53.2. Gjykata do të vendosë sipas rrethanave nëse shpenzimet që ka bërë trashëgimlënësi për shkollimin e mëtejshëm të trashëgimtarëve do të llogariten në pjesën trashëgimore të tyre dhe në ç'masë, duke marrë parasysh sidomos vlerën e pasurisë trashëgimore dhe shpenzimet e shkollimit si dhe aftësinë e trashëgimtarëve të tjerë për të mbajtur veten.

**DHURIMET E RËNDOMTA**

**Neni 54**

Dhurimet e rëndomta nuk llogariten në pjesën trashëgimore.

**DHURIMET E BËRA PERSONIT TË ZËVENDËSUAR NGA NJË TJETËR NË TRASHËGIMI**

**Neni 55**

55.1. Nëse një person është zëvendësuar si trashëgimtar nga një ose disa persona të tjerë sepse ka qënë i padenjë, ose është përjashtuar nga trashëgimia me testament, ose është privuar nga pjesa e domosdoshme, çdo dhurim që i është bërë personit që zëvendësohet nuk llogaritet në pjesën e trashëgimtarit apo trashëgimtarëve që e zëvendësojnë atë në trashëgim.

55.2. Nëse një person zëvendësohet si trashëgimtar nga një ose disa persona të tjerë për shkak se ai ka vdekur para trashëgimlënësit, ose për shkak se ka hequr dorë nga trashëgimia, çdo dhurim që i është bërë këtij personi llogaritet në pjesën e trashëgimtarit apo të trashëgimtarëve që e zëvendësojnë atë në trashëgim.

**LLOGARITJA E BORXHIT TË TRASHËGIMTARIT NDAJ TRASHËGIMLËNËSIT**

**Neni 56**

Çdo borxh i trashëgimtarit ndaj trashëgimlënësit do të llogaritet në pjesën e atij trashëgimtarit sipas rregullave të përgjithshme për kompensimin .

**KUSH MUND TË KËRKOJË LLOGARITJEN**

**Neni 57**

Secili trashëgimtar ka të drejtën të kërkojë që dhurimet dhe legët të llogariten në pjesën trashëgimore të një trashëgimtarit tjetër.



**KREU I TRETË****TRANSANKSIONET NDËRMJET TË  
GJALLËVE (INTER VIVOS)****CEDIMI DHE NDARJA E PASURISË NË  
PËRGJITHËSI****Neni 58**

Paraardhësi me anë të veprimit juridik për së gjalli mund t'ua cedojë dhe t'ua pjesëtojë pasurinë e vet pasardhësve të tij.

**KUSHTET PËR VLEFSHMËRINË E CEDIMIT  
DHE Pjesëtimi****Neni 59**

59.1. Ky cedim dhe pjesëtim i pasurisë është i vlefshëm vetëm nëse janë pajtuar me këtë të gjithë pasardhësit e ceduesit që do të ishin trashëgimtarët ligjorë të ceduesit në kohën kur është bërë cedimi.

59.2. Marrëveshja mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë duhet të përpilohet me shkrim dhe të vërtetohet nga gjyqtari.

59.3. Me rastin e vërtetimit gjyqtari e lexon kontratën dhe u shpjegon kontraktuesve pasojat e kontratës.

59.4. Në qoftë se ndonjë pasardhës nuk ka dhënë pëlqimin, mund ta japë më vonë, në të njëjtën formë.

59.5. Cedimi dhe pjesëtimi mbeten të vlefshëm nëse pasardhësi që nuk e ka dhënë pëlqimin ka vdekur para ceduesit pa lënë pasardhës, ose nëse ky pasardhës ka hequr dorë nga trashëgimi, ose ky pasardhës është bërë i padenjë.

**OBJEKTI I CEDIMIT DHE I Pjesëtimit****Neni 60**

60.1. Cedimi dhe pjesëtimi kanë efekte vetëm përsa i përket pasurisë së trashëgimlënësit në kohën e arritjes së marrëveshjes, ose për një pjesë të saj.

60.2. Çdo dispozitë, e cila parashikon pjesëtimin e pasurisë të fituara nga ceduesi pas bërjes së marrëveshjes konsiderohet nul.

**PASURIA E CEDUAR NUK HYN NË PASURINË  
TRASHËGIMORE****Neni 61**

61.1. Nëse trashëgimlënësi ka bërë cedimin dhe pjesëtimin e të gjithë apo një pjese të pasurisë së tij midis të gjallëve, pasuria e tij trashëgimore do të përbëhet vetëm nga pasuria që nuk është ceduar dhe pjesëtuar, si dhe të çdo pasuri që ka fituar pas cedimit dhe pjesëtimin.

61.2. Pasuria që kanë marrë paraardhësit e tij me anë të cedimit dhe pjesëtimin nuk hyn në pasurinë trashëgimore të ceduesit dhe as nuk merret parasysh në përcaktimin e vlerës së pasurisë trashëgimore.

**KUR KONSIDEROHEN Pjesët  
E CEDUARA SI DHURIME****Neni 62**

62.1. Në qoftë se me cedimin dhe pjesëtimin nuk është pajtuar ndonjëri nga pasardhësit, atëherë pjesët e pasurisë që u janë ceduar pasardhësve të tjerë konsiderohen si dhurime dhe pas vdekjes së pasardhësit me to do të veprohet sikurse me dhurimet e bëra trashëgimtarëve.

62.2. Dispozita nga paragrafi 1 i këtij Neni zbatohet edhe kur ceduesit, pas cedimit dhe pjesëtimin të bërë me marrëveshje me të gjithë trashëgimtarët, i lind fëmija ose paraqitet trashëgimtari që ka qenë shpallur i vdekur.

**RUAJTJA E SË DREJTËS ME RASTIN  
E CEDIMIT DHE Pjesëtimit****Neni 63**

63.1. Me rastin e cedimit dhe pjesëtimin, ceduesi mund të ruajë të drejtën e uzufuktit në të gjitha të mirat e ceduara, ose në disa prej tyre, për vete, ose për bashkëshortin e vet, ose

## LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

për vete dhe për bashkëshortin e vet, ose për ndonjë person tjetër, ose të kontraktojë rentën e përjetshme në natyrë ose në të holla, ose mbajtjen e përjetshme.

63.2. Në qoftë se uzufukti ose renta e përjetshme janë kontraktuar për ceduesin dhe bashkëshortin e tij së bashku, në rast vdekjeje të ndonjërit prej tyre uzufukti ose renta i takon në tërësi tjetrit gjer në vdekjen e tij, po qe se nuk është kontraktuar ndonjë gjë tjetër, apo nëse nuk del ndonjë gjë tjetër nga rrethanat e rastit.

### TË DREJTAT E BASHKËSHORTIT TË CEDUESIT

#### Neni 64

Nëse ceduesi është i martuar në çastin e arritjes së marrëveshjes, cedimi dhe pjesëtimi kërkojnë pëlqimin e bashkëshortit, ose në vetë kontratën, ose më vonë sipas kushteve të parapara në nenin 59.

### BORXHET E CEDUESIT

#### Neni 65

65.1. Pasardhësit midis të cilëve ceduesi ka pjesëtuar pasurinë e vet nuk përgjigjen për borxhet e tij, po qe se nuk është caktuar gjë tjetër me rastin e cedimit dhe të pjesëtimit.

65.2. Kreditorët e ceduesit mund të kundërshtojnë cedimin dhe pjesëtimin sipas dispozitave të parapara për kundërshtimin e disponimeve pa shpërblim të debitorit.

### SHUARJA E KONTRATËS

#### Neni 66

66.1. Ceduesi ka të drejtë të kërkojë që pasardhësi t'ia kthejë atë që ka marrë me anë të cedimit dhe pjesëtimit, po qe se ky ka treguar një mosmirënjohje të vrazhdët të tij. Nëse kthimi (restitucioni) i sendit nuk është i mundur si i tillë (in rem), pasardhësit duhet të kthejnë vlerën në pajtim me dispozitat për pasurimim pa bazë.

66.2. Të njëjtën të drejtë e ka ceduesi në qoftë se pasardhësi nuk i jep atij ose dikujt tjetër ushqimin e caktuar me marrëveshjen e cedimit dhe të pjesëtimit, apo nëse nuk paguan borxhet e ceduesit për pagimin e të cilave është ngarkuar me të njëjtën marrëveshje.

66.3. Në rastet e tjera të detyrimeve të papërbushura të përcaktuara në marrëveshjen e cedimit dhe të pjesëtimit gjykata, duke i kushtuar kujdes rëndësisë së detyrimit për cedimin dhe rrethanave të tjera të rastit, do të vendosë se a ka të drejtë ceduesi të kërkojë kthimin e të mirave që i ka dhënë apo vetëm të drejtën për mbushjen e detyrimeve.

### TË DREJTAT E TRASHËGIMTARËVE PAS SHUARJES SË KONTRATËS

#### Neni 67

67.1. Pasardhësi që ka qenë i detyruar t'i kthejë ceduesit atë që ka marrë me rastin e cedimit dhe pjesëtimit do të mund të kërkojë pjesën e vet të detyrueshme pas vdekjes së ceduesit, me kusht që të mos jetë përjashtuar nga trashëgimi, të mos jetë i padenjë të trashëgojë ceduesin dhe të mos ketë hequr dorë nga trashëgimi.

67.2. Kur llogaritet madhësia e pjesës së domoshme të tij, pjesët e pasurisë që trashëgimlënësi gjatë jetës së vet ua ka ceduar dhe pjesëtuar pasardhësve të tjerë të tij do të konsiderohen si dhurim.

### KONTRATA PËR MBAJTJEN E PËRJETSHME

#### Neni 68

Kontrata e mbajtjes së përjetshme rregullohet nga Ligji për Detyrimet.

**KREU I KATËRT****TRASHËGIMIA ME TESTAMENT****KUPTIMI I TESTAMENTIT****Neni 69**

69.1. Testament do të thotë shprehje e vullnetit të fundit e dhënë në formën e paraparë me ligj, me të cilin trashëgimlënësi (testatori) urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij.

69.2. Dy ose më shumë persona nuk mund të bëjnë një testament me të njëjtin akt, as në dobi të një të personi të tretë, as sa i përket disponimeve reciproke.

**I - KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR VLEFSHMËRINË E TESTAMENTIT****ZOTËSIA PËR TË PËRPILUAR TESTAMENT****Neni 70**

70.1. Testament mund të bëjë çdo person që ka zotësi për të vepruar dhe i cili i ka mbushur 18 vjet.

70.2. Testament mund të bëjë edhe personi që ka zotësi për të vepruar e i ka mbushur 16 vjet dhe është i martuar.

70.3. Vlefshmëria e testamentit nuk preket nëse testatori humb zotësinë për të vepruar pas përpilimit të testamentit.

70.4. Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e përpilimit (bërjes) së testamentit nuk është në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

Pavlefshmëria e testamentit për shkak të të metave në vullnetin e trashëgimlënësit

**Neni 71**

71.1. Testamentit është i pavlefshëm nëse është bërë me kanosje, shtrëngim ose mashtrim.

71.2. Disponimet me testament janë të pavlefshme edhe kur ekziston lajthimi mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin që t'i bëjë këto disponime.

71.3. Në qoftë se vetëm disa dispozita të testamentit janë bërë me kanosje ose me shtrëngim, për shkak të mashtrimit ose në lajthim, atëherë vetëm këto dispozita konsiderohen të pavlefshme.

**NULIMI I TESTAMENTIT PËR SHKAK TË PAAFTËSISË SË TRASHËGIMLËNËSIT DHE PËR SHKAK TË TË METAVE NË VULLNETIN E TIJ****Neni 72**

72.1. Nulimin e testamentit për shkak të paaftësisë së testatorit për të vepruar ose për shkak se testatori nuk ka pasur moshë madhore, si dhe nulimin e testamentit ose të disa dispozitave të tij për shkak të kanosjes ose shtrëngimit, mashtrimit ose lajthimit, mund ta kërkojë vetëm personi që ka interes juridik, brenda afatit prej një viti nga dita kur ka marrë dijeni se ekziston një shkaqet e pavlefshmërisë, e më së largu 10 vjet nga shpallja e testamentit.

72.2. Afati prej një viti nuk mund të fillojë para se të shpallet testamenti.

72.3. Nulimi i testamentit ndaj personit me keqbesim mund të kërkojë 20 vjet pas shpalljes së testamentit.

**ZBATIMI SIPAS TERRITORIT****Neni 73**

Është i plotëfuqishëm ai testament i përpiluar në Kosovë që është bërë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## II - FORMAT E TESTAMENTIT

### A). TESTAMENTI I SHKRUAR NGA VETË TESTATORI

#### Neni 74

74.1. Testamenti është i vlefshëm në qoftë se testatori e ka shkruar atë, datuar dhe nënshkruar me dorën e vet ose ka vënë gishtin e vet.

74.2. Data e testamentit duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin.

74.3. Nënshkrimi duhet të përmbajë mbiemrin e testatorit si dhe të paktën njërin prej emrave të tij dhe duhet vënë në fund të testamentit.

### B). TESTAMENTI ME SHKRIM NË PRANINË E DËSHMITARËVE

#### Neni 75

75.1. Testatori që di të shkruajë e të lexojë mund të bëjë testamentin duke nënshkruar me dorë dokumentin pa marrë parasysh kush e ka përpiluar, në praninë e dy dëshmitarëve që e kuptojnë gjuhën e testamentit, duke deklaruar para tyre se testamenti është i tij.

75.2. Dëshmitarët nënshkruhen në vetë testamentin dhe është e dobishme të shënohet cilësia e tyre si dëshmitarë.

### C). TESTAMENTI GJYQËSOR

#### TESTAMENTI GJYQËSOR NËSE TESTATORI ËSHTË NË GJENDJE TA LEXOJË

#### Neni 76

76.1. Testamentin mund t'ia përpilojë testatorit sipas kërkesës së tij gjyqtari i gjykatës kompetente, i cili më parë duhet të vërtetojë identitetin e testatorit.

76.2. Testamentin e përpiluar, gjyqtari t'ia lexon testamentin testatorit dhe e njofton me pasojat juridike të testamentit të përpiluar.

76.3. Pasi të lexojë dhe të nënshkruajë testatori testamentin e këtillë, gjyqtari shënon në vetë testamentin se testatori e ka lexuar dhe e ka nënshkruar atë në praninë e tij.

#### TESTAMENTI GJYQËSOR NËSE TESTATORI NUK ËSHTË NË GJENDJE TA LEXOJË.

#### Neni 77

77.1. Në rast se testatori nuk është në gjendje të lexojë testamentin që ia ka përpiluar gjyqtari, ky ia lexon testatorit në praninë e dy dëshmitarëve. Testatori pastaj në praninë e po këtyre dëshmitarëve e nënshkruan testamentin ose e vë në të shenjën e gishtit të vet, pasi të deklarojë se ky është testamenti i tij.

77.2. Dëshmitarët duhet ta nënshkruajnë testamentin.

77.3. Gjyqtari duhet të konstattojë në procesverbal se të gjitha këto veprime janë bërë.. Ky procesverbal duhet nënshkruar nga testatori, dëshmitarët dhe gjyqtari.

#### DORËZIMI I TESTAMENTIT NË GJYKATË PËR RUAJTJE

#### Neni 78

78.1. Testatori mund t'ia besojë për ruajtje gjykatës kompetente testamentin e bërë me dorën e vet, testamentin me shkrim në prani të dëshmitarëve ose testamentin gjyqësor në zarf të hapur ose të mbyllur.

78.2. Gjykata bën një procesverbal për testamentin që ka marrë, kurse vetë testamentin e vendos në një zarf të veçantë, të cilin e vulos dhe e ruan në gjykatë.

Kush mund të jetë dëshmitar kur përpilohet testamenti me shkrim në prani të dëshmitarëve dhe në testamentin gjyqësor.

**Neni 79**

79.1. Kur bëhet testamenti me shkrim në prani të dëshmitarëve (Neni 80) dhe testamenti gjyqësor (Neni 82), dëshmitarë duhet të jenë personat madhorë, të cilëve nuk u është hequr zotësia për të vepruar dhe që dinë të shkruajnë, të lexojnë dhe të kuptojnë gjuhën e testamentit.

79.2. Nuk mund të jenë dëshmitarë kur përpilohet testamenti me shkrim në prani të dëshmitarëve dhe testamenti gjyqësor, as të përpilojnë testamentin sipas tregimit të testatorit personat me cilësinë e gjyqtarit, pasardhësit e testatorit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, parardhësit e tij, prindërit e tij adoptues, personat e tij në gjini në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, bashkëshortët e të gjithë këtyre personave dhe bashkëshorti i testatorit.

**DISPONIMI NË DOBI TË GJYQTARIT, TË  
DËSHMITARËVE DHE TË KUSHËRINJVE TË  
AFËRT TË TYRE**

**Neni 80**

Janë të pavlefshme dispozitat e testamentit me të cilat i lihet diçka gjyqtarit që ka përpiluar testamentin, dëshmitarëve me rastin e përpilimit të tij, si dhe paraardhësve, pasardhësve, vëllezërve e motrave dhe bashkëshortëve të këtyre personave.

**D) . TESTAMENTI NË RRETHANA TË  
JASHTËZAKONSHME**

**TESTAMENTI ME GOJË****Neni 81**

Testatori mund të deklarojë vullnetin e tij të fundit me gojë para dy dëshmitarëve, vetëm në qoftë se për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në gjendje të bëjë testamentin me shkrim.

**DËSHMITARËT E TESTAMENTIT ME GOJË****Neni 82**

Kur bëhet testamenti me gojë dëshmitarë mund të jenë vetëm ata personat që mund të jenë dëshmitarë kur bëhet testamenti gjyqësor, por nuk janë domosdoshmërisht të detyruar të dinë të shkruajnë e të lexojnë.

**DETYRAT E DËSHMITARËVE TË TESTAMENTIT  
ME GOJË**

**Neni 83**

83.1. Dëshmitarët para të cilëve testatori ka deklaruar me gojë vullnetin e tij të fundit kanë për detyrë të përpilojnë deklaratën me shkrim të testatorit dhe ta dorëzojnë atë sa më parë në gjykatë, ose ta përsërisin me gojë para gjykatës, duke treguar kur, ku dhe në çfarë rrethanash testatori ka deklaruar vullnetin e tij të fundit.

83.2. Testamenti me gojë bëhet i pavlefshëm nëse nuk deklarohet në gjykatë nga dëshmitarët 30 ditë pas pushimit të rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat ai është bërë, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. Në lidhje me këtë periudhë aplikohen dispozitat e Ligjit të Detyrimeve mbi ndërprerjen dhe pezullimin e afatit të parashkrimit.

**DISPONIMI I TESTAMENTIT ME GOJË NË DOBI  
TË DËSHMITARËVE DHE TË PERSONAVE TË  
TYRE TË AFËRT**

**Neni 84**

Janë të pavlefshme disponimet e testamentit me gojë me të cilat u lihet diçka dëshmitarëve me rastin e përpilimit të tij, bashkëshortëve të tyre, të paraardhësve të tyre, pasardhësve të tyre, personave në gjini gjaku të tyre në vijë të tërthortë gjer në shkallën e katërt dhe të bashkëshortëve të të gjithë këtyre personave.

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

**NULIMI I TESTAMENTIT PËR MUNGESË SË  
FORMËS SË KËRKUAR**

**Neni 85**

85.1. Nulimin e testamentit për shkak të mungesës së formës të kërkuar mund ta kërkojë, pas hapjes së trashëgimisë, vetëm personi që ka interes juridik, brenda afatit prej një viti nga dita që ka marrë dijeni për testamentin, e më së largu brenda 10 vjetësh pas shpalljes së testamentit.

85.2. Afati prej një viti fillon me shpalljen e testamentit.

**TË PROVUARIT E TESTAMENTIT TË ASGJË-  
SUAR, TË HUMBUR, OSE TË HARRUAR**

**Neni 86**

Testamenti i asgjësuar rastësisht ose me vepri-min e ndonjë personi tjetër, i humbur, i harruar diku pas vdekjes së testatorit ose para vdekjes së tij, por pa vullnetin e tij, do të prodhojë efektet e testamentit të vlefshëm po qe se personi i interesuar provon se testamenti ka ekzistuar, se është asgjësuar, është humbur, është harruar diku, dhe se ka qenë i përpiluar në formën e përcaktuar me ligj dhe nëse provon përmbajtjen e asaj pjese të testamentit në të cilën mbështetet.

**III - PËRMBAJTJA E TESTAMENTIT**

**CAKTIMI I TRASHËGIMTARIT**

**Neni 87**

87.1. Trashëgimlënësi mund të caktojë me tes-tament një ose më shumë trashëgimtarë.

87.2. Trashëgimtarë në bazë të testamentit janë personat të cilët trashëgimlënësi i ka caktuar që të trashëgojnë tërë pasurinë e tij, ose një pjesë të pasurisë.

87.3. Trashëgimtar do të konsiderohet edhe personi të cilit i janë lënë me testament një ose më shumë sende ose të drejta të caktuara,

po qe se vërtetohet vullneti i testatorit që ky person të jetë trashëgimtar i tij.

**DISPONIMI PËR QËLLIME TË LEJUARA DHE  
THEMELIMI I FONDACIONIT**

**Neni 88**

88.1. Testatori mund të urdhërojë me testament që një send ose e drejtë ose një pjesë e pasurisë trashëgimore ose tërë pasuria trashëgimore të përdoret për të arritur një qëllim të lejuar.

88.2. Në qoftë se testatori ka urdhëruar të themelohet fondacioni dhe ka caktuar mjetet për të arritur qëllimin e tij, fondacioni ekziston nga momenti i marrjes së lejes nga organi kompetent.

88.3. Kur testatori ia lë me testament pasurinë organeve publike, ose institucioneve të tjera, ai mund të caktojë në testament qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria.

**BARRËT DHE KUSHTET**

**Neni 89**

89.1. Testatori mund të ngarkojë me ndonjë detyrim personin të cilit i lë ndonjë përfitim nga pasuria trashëgimore.

89.2. Dispozitat testamentare mund të bëhen me kushte ose afate.

89.3. Kushtet dhe barrët e pamundshme, të palejuara dhe jomorale, si dhe ato që janë të pakuptueshme ose kontradiktore, konsiderohen sikur nuk ekzistojnë.

**CAKTIMI I TRASHËGIMTARËVE DHE I  
SHFRYTËZUESVE TË TJERË**

**Neni 90**

Trashëgimtarët, legatarët dhe personat e tjerë, të cilëve u janë lënë me testament disa përfitime, konsiderohen të caktuar në qoftë se tes-tamenti përmban shënime në bazë të të cilave mund të vërtetohet se kush janë ata.

## INTERPRETIMI I TESTAMENTIT

### Neni 91

91.1. Dispozitat e testamentit interpretohen sipas qëllimit të vërtetë të testatorit.

91.2. Në rast dyshimi duhet përmbajtur asaj që është më e përshtatshme për trashëgimtarin ligjor ose për personin që i është ngarkuar me testament ndonjë detyrim.

## IV - LEGU

### LËNIA E LEGUT

#### Neni 92

Testatori mund të lërë me testament një ose më shumë lege.

### PËRMBAJTJA E LEGUT

#### Neni 93

93.1. Testatori mund të lërë me testament një ose më shumë sende të caktuara ose ndonjë të drejtë personit të caktuar, të urdhërojë trashëgimtarin ose ndonjë person tjetër, të cilit i lë diçka që nga ajo që i është lënë të japë ndonjë send një personi të caktuar, t'i paguajë një shumë të hollash, ta lirojë nga ndonjë borxh e ta mbajë ose në përgjithësi të bëjë diçka, të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitojë diçka në dobi të tij.

93.2. Kjo mënyrë e të trashëguarit quhet leg, kurse personi të cilit i është destinuar legu quhet legatar.

### DETYRIMI I EKZEKUTIMIN TË LEGUT

#### Neni 94

94.1. Në bazë të testamentit legatari ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e legut nga personi që është ngarkuar me testament që të ekzekutojë legun.

94.2. Në qoftë se për ekzekutimin e legut janë ngarkuar disa persona, secili përgjigjet në

përpjestim me pjesën e pasurisë trashëgimore që merr, përveç nëse nga testamenti mund të konkludohet se testatori ka dashur që ata të përgjigjen në mënyrë tjetër.

## LEGU I LËNË ORGANEVE PUBLIKE OSE INSTITUCIONEVE

### Neni 95

Kur testatori ia lë me testament pasurinë organeve publike ose institucioneve të ndryshme ka të drejtë të caktojë qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria.

### EKZEKUTIMI I LEGUT

#### Neni 96

96.1. Kur trashëgimtar i ngarkuar me legun ose barrën ka vdekur para testatorit ose është bërë i padenjë, ka hequr dorë nga trashëgimi dhe testatori nuk ka caktuar një trashëgimtar tjetër në vend të tij për përmbushjen e detyrimeve në lidhje me legun ose me barrën, ngarkohen bashkëtrashëgimtarët ose trashëgimtarët ligjor, të cilëve u shtohet ose u kalon pjesa e atij që për shkaqet e mësipërme nuk mund ose nuk do të jetë trashëgimtar.

96.2. Në qoftë se përmbushja e detyrimeve në lidhje me legun ose barrën është lidhur ngushtë me personin që për shkaqet e mësipërme nuk mund ose nuk do të jetë trashëgimtar, legu dhe barra bëhet e pavlefshme.

### EKZEKUTIMI PROPORCIONAL

#### Neni 97

Në rast se ndërmjet trashëgimtarëve asnjëri prej tyre nuk është ngarkuar nga trashëgimlënësi testamentar për të përmbushur legun, secili trashëgimtar detyrohet të kontribuojë për përmbushjen e tij sipas pjesës takuese.

## ZVOGËLIMI I LEGEVE DHE I BARRËVE

### Neni 98

98.1.Trashëgimtari nuk është i detyruar të ekzekutojë në tërësi leget, vlera e të cilave tejkalon vlerën e asaj pjese të trashëgimit të pasurisë, të cilën trashëgimlënësi ka mundur ta disponojë lirisht.

98.2.Kjo vlen edhe për legatarin, në qoftë se vlera e legeve ose e barrëve që duhet t'i ekzekutojë tejkalon vlerën e legut të tij.

98.3.Në këto raste të gjitha leget dhe barrët zvogëlohen në përpjestim të njëjtë, po që se trashëgimlënësi nuk ka urdhëruar ndonjë gjë tjetër.

## SHUARJA E LEGUT NË PËRGJITHËSI

### Neni 99

Legu shuhet në qoftë se legatari vdes para trashëgimlënësit, heq dorë nga legu ose është i padenjë. Në këto raste objekti i legut i mbetet personit që ka qenë i detyruar ta ekzekutojë, po që se nga vetë testamenti nuk rezulton ndryshe.

## SHURJA NË LIDHJE ME OBJEKTIN E LEGUT

### Neni 100

Legu shuhet edhe kur trashëgimlënësi ka shpenzuar objektin e legut, ose ky objekt vetëvetiu ka pushuar së ekzistuari derisa ka qenë gjallë testatori, ose rastësisht është asgjësuar pas vdekjes së tij.

## PARASHKRIMI I LEGUT

### Neni 101

E drejta për të kërkuar ekzekutimin e legut parashkruhet brenda 1 viti nga dita kur legatari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe ka qenë i autorizuar të kërkojë ekzekutimin e legut, e më se voni prej 3 vjetëve nga dita kur ka pasur mundësi të kërkojë ekzekutimin e legut.

## V - EKZEKUTUESIT

### CAKTIMI I EKZEKUTUESIT TË TESTAMENTIT

#### Neni 102

102.1.Testatori mund të caktojë me testament një ose më shumë persona si ekzekutues të testamentit.

102.2. Ekzekutues i testamentit mund të jetë çdo person që ka zotësi për të vepruar.

102.3. Personi që është caktuar të jetë ekzekutues i testamentit nuk është detyruar të marrë përsipër këtë detyrë.

### DETYRAT E EKZEKUTUESIT TË TESTAMENTIT

#### Neni 103

103.1. Pëveç rasteve kur testatori nuk ka caktuar ndonjë gjë tjetër, ekzekutuesi i testamentit ka sidomos për detyrë të kujdeset për ruajtjen e pasurisë trashëgimore, ta drejtojë atë, të kujdeset për pagimin e borxheve dhe legeve, dhe në përgjithësi të kujdeset që testamenti të ekzekutohet ashtu si ka dashur testatori.

103.2. Në qoftë se ka disa ekzekutues të testamentit ata kryejnë detyrat që u janë besuar së bashku, përveç nëse trashëgimlënësi ka caktuar ndryshe.

### DHËNIA E LLOGARISË DHE SHPËRBLIMI I EKZEKUTUESIT

#### Neni 104

104.1.Ekzekutuesi i testamentit është i detyruar t'i japë llogari gjykatës për punën e vet.

104.2.Ai ka të drejtë për shpërblimin e shpenzimeve dhe shpërblimin për punën e vet që do të paguhet në ngarkim të pjesës disponibël të pasurisë trashëgimore e sipas vendimit të gjykatës.



## SHKARKIMI I EKZEKUTUESIT TË TESTAMENTIT

### Neni 105

105.1. Gjykata në bazë të propozimit, ose sipas detyrës zyrtare, mund të shkarkojë ekzekutuesin e testamentit, po që se puna e tij nuk është në pajtim me vullnetin e testatorit ose me ligjin.

105.2. Ekzekutuesi i shkarkuar i testamentit përgjigjet për dëmin që është shkaktuar nga veprimi, të cilin do ta kryente si ekzekutues i testamentit.

## EKZEKUTUESI I CAKTUAR NGA GJYKATA

### Neni 106

Testatori mund t'i kërkojë Gjykatës Trashëgimore të emërojë një ekzekutues, ose të emërojë një të tillë nëse ekzekutuesi i caktuar nga testatori refuzon të marrë detyrën ose është shkarkuar nga Gjykata Trashëgimore.

## VI - REVOKIMI I TESTAMENTIT

### Neni 107

107.1. Trashëgimlënësi mund të revokojë kurdoherë testamentin në tërësi ose pjesërisht në njërën nga format e parapara me ligj për përpilimin e testamentit.

107.2. Trashëgimlënësi mund të revokojë testamentin me shkrim dhe me asgjësimin e dokumentit.

## RAPORTI MIDIS TESTAMENTIT TË MËPARSHËM DHE TË MËVONSHËM Neni 108

108.1. Në qoftë se me testamentin e mëvonshëm nuk revokohet shprehimisht testamenti i mëparshëm dispozitat e testamentit të mëparshëm mbeten në fuqi, po që se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e testamentit të mëvonshëm.

108.2. Në qoftë se trashëgimlënësi ka asgjësuar testamentin e mëvonshëm, testamenti i mëparshëm mbetet në fuqi.

## DISPONIMI I SENDIT TË LËNË ME TESTAMENT

### Neni 109

Çdo disponim i mëvonshëm nga ana e testatorit të sendit të caktuar që ia ka lënë diku me testament ka si pasojë revokimin e lënies me testament të këtij sendi.

## KREU I PESTË

## PADENJËSIA DHE PËRJASHTIMI I TRASHËGIMTARËVE TË DOMOSDOSHËM

### I - PADENJËSIA

#### PADENJËSIA NË PËRGJITHËSI

### Neni 110

110.1. Nuk mund të trashëgojë personi i padenjë për të trashëguar.

110.2. Padenjësia nuk i pengon pasardhësit e personit të padenjë të trashëgojnë njësoj sikur personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

#### PADENJËSIA PËR TRASHËGIM

### Neni 111

I padenjë për të trashëguar është ai person që:

a) Me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e tij;

b) Ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lirie;

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

c) Me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;

d) Është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë;

e) Nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtur apo ndihmuar trashëgimlënësin.

**VLERËSIMI KRYESISHT I PADENJËSISË  
NGA GJYKATA**

**Neni 112**

Për padenjësinë gjykata kujdeset kryesisht përveç në rast padenjësie për shkeljen e detyrimit të mbajtjes dhe për mosdhënien e ndihmës së domosdoshme trashëgimlënësit.

**FALJA E PADENJËSISË**

**Neni 113**

Trashëgimlënësi ka të drejtë të falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me testament, ose kur faljen, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë dhe megjithatë e cakton atë si trashëgimtar.

**II- PËRJASHTIMI I TRASHËGIMTARËVE TË  
DOMOSDOSHËM NGA TRASHËGIMI DHE PRIV-  
IMI NGA PJESA E DOMOSDOSHME NË DOBI  
TË PASARDHËSVE.**

**SHKAQET E PËRJASHTIMIT**

**Neni 114**

Trashëgimlënësi në testamentin e tij mund të përjashtojë nga trashëgimi trashëgimtarin që ka të drejtë për pjesën e domosdoshme:

a) Në qoftë se ai me shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor ose moral ka bërë cenim të rëndë ndaj trashëgimlënësit;

b) Në qoftë se ka bërë me dashje ndonjë vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijës ose prindit të tij;

c) Në qoftë se është plangprishës, nuk do të punojë ose është dhënë pas jetës së pander-  
shme.

**PËRJASHTIMI I PLOTË OSE I PJESSHËM**

**Neni 115**

Përjashtim nga trashëgimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm.

**KUSHTET PËR VLEFSHMËRINË  
E PËRJASHTIMIT**

**Neni 116**

116.1.Trashëgimlënësi që dëshiron të përjashtojë ndonjë trashëgimtar duhet ta shprehë këtë në mënyrë të qartë si dhe të tregojë shkakun e këtij përjashtimi.

116.2.Shkaku i përjashtimit duhet të ekzistojë në kohën e përpilimit të testamentit.

116.3.Në rast kontesti rreth bazueshmërisë së përjashtimit, detyrën për të provuar se përjashtimi është i arsyeshëm e ka ai që mbështetet në përjashtim.

**PASOJAT E PËRJASHTIMIT**

**Neni 117**

Me përjashtimin trashëgimtari humb të drejtat trashëgimore në vëllimin në të cilin është përjashtuar, kurse të drejtat e personave të tjerë që mund të trashëgojnë trashëgimlënësin caktohen sikur i përjashtuari të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

## PRIVIMI NGA PJESA E DOMOSDOSHME NË DOBI TË TRASHËGIMTARËVE

### Neni 118

118.1. Në qoftë se trashëgimtari i domosdoshëm ka shumë borxhe ose është plangprishës, trashëgimlënësi mund ta privojë në tërësi ose pjesërisht nga pjesa e domosdoshme e tij në dobi të pasardhësve të tij.

118.2. Ky privim mbetet i plotëfuqishëm vetëm nëse në momentin e hapjes së trashëgimisë i privuari ka fëmijën e mitur ose nipin e mitur nga fëmija i vdekur më parë ose ka fëmijën madhor ose nipin madhor nga fëmija i vdekur më parë që janë të paaftë për punë.

## KREU I GJASHTË

### KREDITORËT E PASURISË

#### BORXHET E TRASHËGIMISË NË PËRGJITHËSI

### Neni 119

119.1. Trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet që ngarkojnë trashëgiminë në proporcion me pjesën e tyre dhe deri në vlerën e tyre të pjesës trashëgimore.

119.2. Borxhet që ngarkojnë trashëgiminë janë: barrët mbi trashëgiminë, borxhet personale të trashëgimlënësit, shpenzimet e varrimit, shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë deri në momentin e ndarjes së trashëgimisë.

#### PËRGJEGJËSIA E LEGATARIT PËR BORXHET E TRASHËGIMLËNËSIT

### Neni 120

Legatari nuk përgjigjet për borxhet e trashëgimlënësit nëse trashëgimlënësi nuk ka përcaktuar ndryshe në testament.

## LEGU I LËNË KREDITORIT

### Neni 121

Kur testatori i ka lënë legun kreditorit të vet, ky ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit ndaj tij, po që se nga testamenti nuk rezulton se qëllimi i trashëgimlënësit ka qenë ndryshe.

#### PRIORITETI I KREDITORËVE MBI LEGATARËT

### Neni 122

122.1. Kreditorët e trashëgimlënësit kanë përparësi në përmbushjen e kërkesave para legatarëve.

122.2. Nëse leget janë ekzekutuar para pagimit të kreditorëve, kreditorët duhet ta kërkojnë këtë leg sipas dispozitave të ligjit të detyrimeve për pasurimin e pa bazë.

#### VEÇIMI I PASURISË TRASHËGIMORE

### Neni 123

123.1. Kreditorët e trashëgimlënësit brenda afatit prej tre muajsh nga hapja e trashëgimit mund të kërkojnë që pasuria trashëgimore të veçohet nga pasuria e trashëgimtarit. Në këtë rast trashëgimtari nuk mund të disponojë sendet dhe të drejtat e pasurisë trashëgimore, as të paguajë kreditorët e tij prej trashëgimisë, derisa nuk janë paguar kreditorët që kanë kërkuar veçimin.

123.2. Kreditorët e trashëgimlënësit që kanë kërkuar veçimin e pasurisë trashëgimore borxhet e veta mund t'i nxjerrin vetëm nga pasuria trashëgimore.

123.3. Për pasurinë trashëgimore të veçuar gjykata mund të caktojë kujdestar.

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

**PJESA E DYTË**

**KALIMI I PASURISË TRASHËGIMORE TE TRASHËGIMTARËT**

**I - HAPJA E TRASHËGIMIT**

**VDEKJA DHE SHPALLJA E PERSONIT I VDEKUR**

**Neni 124**

124.1.Me vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij.

124.2.Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit si të vdekur.

**HAPJA E TRASHËGIMIT TË PERSONIT TË SHPALLUR I VDEKUR DHE FILLIMI I AFATEVE**

**Neni 125**

125.1.Si ditë e hapjes së trashëgimit të personit që është shpallur i vdekur konsiderohet dita kur aktvendimi mbi shpalljen e personit i vdekur ka marrë formën e prerë, po qe se në vetë vendimin si ditë e vdekjes nuk është caktuar ndonjë ditë tjetër.

125.2. Në rast të shpalljes së personit i vdekur, afatet fillojnë të llogariten nga dita kur aktvendimi për shpalljen e tij person i vdekur ka marrë formën e prerë.

**ZOTËSIA PËR TË TRASHËGUAR**

**Neni 126**

126.1.Trashëgimtar mund të jetë vetëm personi i cili është i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimit.

126.2.Fëmija i zënë në çastin e hapjes së trashëgimit do të konsiderohet si i lindur, në qoftë se lind i gjallë.

126.3.Në qoftë se dy ose më shumë persona humbin jetën në të njëjtin aksident, ose kur

nuk dihet rendi kronologjik i vdekjes së tyre, konsiderohet se asnjëri prej tyre nuk ka qenë i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimisë së tjetrit.

**TRASHËGIMTARËT E PANJOHUR**

**Neni 127**

127.1.Në qoftë se nuk dihet nëse ka trashëgimtarë, gjykata me anë të shpalljes do t'i thërrasë personat që pretendojnë se kanë të drejtë për trashëgim që të paraqiten në gjykatë.

127.2.Në qoftë se me kalimin e një viti nga dita e shpalljes nuk paraqitet asnjë trashëgimtar, pasuria trashëgimore i dorëzohet komunës kompetente, por me këtë trashëgimtar që do të paraqitet më vonë nuk privohet nga e drejta që t'i dorëzohet pasuria trashëgimore ose pjesa që i takon.

**KUJDESTARIA PËR TRASHËGIMTARËT E PANJOHUR**

**Neni 128**

128.1.Pasuria e paluajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës ndodhet, kurse pasuria e luajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë.

128.2.Në qoftë se trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur vendbanim apo vendqëndrim në Kosovë, pasuria e luajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës ndodhet gjykata trashëgimore.

128.3.Nëse trashëgimtar nuk e ka kërkuar trashëgiminë brenda 20 viteve nga data e shpalljes së testamentit, ose kur nuk ka testament që nga vdekja e trashëgimlënësit, trashëgimlënësi do të konsiderohet pa trashëgimtarë ligjor ose testamentarë dhe do të aplikohen dispozitat e këtij ligji në lidhje me të drejtat në trashëgimi të komunave (Neni 21)

## KUJDESTARI I PASURISË TRASHËGIMORE

### Neni 129

129.1. Kur nuk dihen të gjithë ose disa prej trashëgimtarëve, kur nuk dihet vendqëndrimi i tyre, si edhe në rastet e tjera kur ka nevojë për këtë, gjykata cakton kujdestarin e përkohshëm të pasurisë trashëgimore, i cili është i autorizuar që në emër të trashëgimtarit të padisë dhe të paditet, të realizojë kërkesat dhe të paguajë borxhet dhe të përfaqësojë trashëgimtarët në përgjithësi.

129.2. Caktimi i kujdestarit të përkohshëm nga gjykata për trashëgimtarin që është i paafte të mbrojë interesat e tij apo është i mitur rregullohet me dispozitat e Ligjit të Familjes.

129.3. Gjukata është e autorizuar të caktojë të drejta dhe detyra të veçanta të kujdestarit të pasurisë trashëgimore.

129.4. Nëse vetëm një ose disa bashkëtrashëgimtarë nuk janë të njohur, ose vendbanimi i këtyre bashkëtrashëgimtarëve nuk dihet, gjykata mund të caktojë njërin prej bashkëtrashëgimtarëve të mbetur si kujdestar të trashëgimisë.

## II - HEQJA DORË NGA TRASHËGIMI

### HEQJA DORË NË PËRGJITHËSI

#### Neni 130

130.1. Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin.

130.2. Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se hequr dorë vetëm në emër të vet.

130.3. Në qoftë se pasardhësit janë të mitur për këtë heqje dorë nuk nevojitet leja e organit të kujdestarisë.

130.4. Trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar.

130.5. Në qoftë se për trashëgim kanë hequr dorë të gjithë pasardhësit të cilët i takojnë radhës me të afërt të trashëgimisë në çastin e vdekjes të trashëgimlënësit, në trashëgim thirren pasardhësit e radhës pasuese të trashëgimit.

### KALIMI I SË DREJTËS SË HEQJES DORË NGA TRASHËGIMI

#### Neni 131

131.1. Nëse trashëgimtari ka vdekur para se të përfundojë shqyrtimi i pasurisë trashëgimore dhe nuk ka hequr dorë nga trashëgimi, e drejta e heqjes dorë kalon tek trashëgimtarët e tij.

131.2. Nëse janë disa trashëgimtarë të trashëgimtarit të vdekur, ata nuk janë të detyruar të heqin dorë bashkarisht dhe secili prej këtyre trashëgimtarëve të trashëgimtarit të vdekur mund të heqin dorë për pjesën e trashëgimisë së trashëgimlënësit që i takon pjesës së tij në trashëgiminë e trashëgimtarit të vdekur.

### PERSONI QË NUK MUND TË HEQË DORË NGA TRASHËGIMI

#### Neni 132

132.1. Nuk mund të heqë dorë nga trashëgimi trashëgimtari që ka disponuar tërë pasurinë trashëgimore ose një pjesë të saj.

132.2. Masat që merr një trashëgimtar vetëm për të ruajtur pasurinë trashëgimore, si dhe masat e administrimit vijues, nuk e privojnë nga e drejta që të heqë dorë nga trashëgimi.

### PËRMBAJTJA E DEKLARATËS MBI HEQJEN DORË NGA TRASHËGIMI

#### Neni 133

133.1. Heqja dorë nga trashëgimi nuk mund të jetë e pjesëshme apo me kusht.

133.2. Heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet si heqje dorë nga

LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

trashëgimi, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar.

**HEQJA DORË NGA TRASHËGIMI QË NUK ËSHTË HAPUR**

**Neni 134**

Heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur nuk ka kurrfarë efekti juridik.

**PAREVOKUESHMËRIA E DEKLARATËS PËR HEQJEN DORË OSE PËR PRANIMIN E TRASHËGIMIT DHE NULIMI I SAJ**

**Neni 135**

135.1. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi ose për pranimin e trashëgimit nuk mund të revokohet.

135.2. Trashëgimtari që ka dhënë deklaratën mund të kërkojë nulimin e kësaj deklarate, po qe se ajo është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit.

**SHTIMI**

**Neni 136**

Pjesa e trashëgimitarit me testament që ka hequr dorë nga trashëgimi i takon trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit, po qe se nga vetë testamenti nuk parashikohet ndryshe.

**SI TRASHËGOHET PJESA E PERSONIT QË HEQ DORË NGA TRASHËGIMI**

**Neni 137**

Pjesa e trashëgimisë së trashëgimitarit ligjor që ka hequr dorë nga trashëgimi trashëgohet sikur ky trashëgimtar të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

**PARASHKRIMI I SË DREJTËS PËR TË KËRKUAR PASURINË TRASHËGIMORE**

**Neni 138**

138.1. E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjetë duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes e trashëgimlënësit, kurse për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit.

138.2. Ndaj poseduesit me keqbesim kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vjetësh nga koha parashikuar në paragrafin 1.

**III - NDARJA E TRASHËGIMIT**

**E DREJTA PËR NDARJE**

**Neni 139**

139.1. Ndarjen e trashëgimit mund ta kërkojë çdo trashëgimtar në çdo kohë, por jo në një kohë të papërshtatshme.

139.2. Kjo e drejtë nuk parashkruhet.

139.3. Kontrata me të cilën trashëgimtari heq dorë nga e drejta që të kërkojë ndarjen, si dhe dispozita e testamentit me të cilën ndalohet ose kufizohet ndarja është nul.

**BASHKËSIA E TRASHËGIMISË**

**Neni 140**

140.1. Gjer në kohën e ndarjes trashëgimtarët e administrojnë dhe e disponojnë bashkarisht pasurinë trashëgimore.

140.2. Në qoftë se nuk ka ekzekutues të testamentit e trashëgimtarët nuk pajtohen për administrimin e pasurisë trashëgimore, gjykata me kërkesën e njërit prej tyre do të caktojë administratorin, i cili për të gjithë ata do të

administrojë pasurinë trashëgimore. Gjykata mund t'i caktojë secilit trashëgimtar pjesën e pasurisë trashëgimore që do të administrojë.

140.3. Gjykata mund të caktojë administrator edhe ndonjërin nga trashëgimtarët.

140.4. Administratori me lejen e gjykatës mund të disponojë sende nga pasuria trashëgimore, po qe se është i autorizuar për këtë me testament apo nëse kjo i nevojitet për t'i paguar shpenzimet ose për të mënjanuar ndonjë dëm.

## CEDIMI I PJESËS TRASHËGIMORE PARA NDARJES

### Neni 141

141.1. Çdo trashëgimtar para ndarjes mund të cedojë pjesën e vet trashëgimore në tërësi ose pjesërisht vetëm tek bashkëtrashëgimtarët.

141.2. Kontrata mbi cedimin e pjesës trashëgimore duhet të vërtetohet në gjykatë.

141.3. Kontrata e trashëgimtarit me personin që nuk është trashëgimtar për cedimin e pjesës trashëgimore detyron vetëm trashëgimtarin që pas ndarjes t'ia dorëzojë pjesën e vet bashkëkontraktuesit. Me këtë kontratë bashkëkontraktuesi deri në kohën e ndarjes nuk fiton kurrfarë të drejte tjetër.

141.4. Bashkëtrashëgimtarët kanë të drejtën e parablerjes në pajtim me dispozitat e Ligjit të së Drejtës Reale. Kjo e drejtë parashkruhet për secilin bashkëtrashëgimtar dy muaj pasi bashkëtrashëgimtari është njoftuar me shkrim për transferën. Nëse disa bashkëtrashëgimtarë e ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, ata e fitojnë bashkarisht pjesën e trashëgimisë, në proporcion me pjesët e tyre respektive në raport me gjithë trashëgiminë.

E drejta e trashëgimtarëve që kanë bashkëjetuar ose kanë punuar në një bashkësi me trashëgimlënësin

### Neni 142

142.1. Me kërkesën e trashëgimtarit që ka bashkëjetuar ose ka punuar në një bashkësi me trashëgimlënësin gjykata, kur gjen se ka bazë të arsyeshme për këtë kërkesë, mund të vendosë që t'i lihen disa sende të luajtshme ose të paluajtshme ose grupe sendesh që do t'i takonin pjesës së trashëgimtarëve të tjerë, kurse ky t'u paguajë me të holla vlerën e këtyre sendeve, brenda afatit që cakton gjykata duke marrë parasysh rrethanat e rastit.

142.2. Për shumën e caktuar në këtë mënyrë këta trashëgimtarë derisa ta paguajnë kanë pengun ligjor për pjesët e pasurisë trashëgimore që i janë dhënë trashëgimtarit, i cili është i detyruar t'u bëjë pagesën.

142.3. Në qoftë se nuk u bëhet pagesa brenda afatit të caktuar, ata kanë të drejtë të kërkojnë përmbushjen e detyrimit ose dorëzimin e sendeve që zakonisht do t'u takonin në emër të pjesës trashëgimore.

## NDARJA E SENDEVE TË SHTËPISË

### Neni 143

143.1. Sendet e shtëpisë që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përditshme të trashëgimtarit që ka bashkëjetuar me trashëgimlënësin në të njëjtën familje e që nuk është pasardhës apo bashkëshort i tij, do t'i lihen me kërkesën e tij, kurse vlera e tyre do të llogaritet në pjesën e këtij trashëgimtari.

143.2. Në qoftë se vlera e sendeve tejkalon vlerën e pjesës trashëgimore, trashëgimtari të cilit i janë lënë sendet do t'ua paguajë këtë diferencë trashëgimtarëve të tjerë.

## DETYRIMI I MBROJTJES MIDIS TRASHËGIMTARËVE PAS NDARJES

### Neni 144

144.1. Nëse pas ndarjes:

a. një person i tretë, në zbatim të së drejtës të krijuar para ndarjes në mënyrë të

## LIGJI PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS

ligjshme merr një send që trashëgimtari ka fituar me ndarje, ose në mënyrë të ligjshme kufizon ushtrimin e një të drejte që trashëgimtari ka fituar me ndarje, ose

b. një send i fituar nga trashëgimtari me ndarje ka një defekt të fshehur , ose

c. një kërkesë që i ka kaluar trashëgimtarit me ndarje nuk ekziston, ose nuk mund nxirret në vlerën e plotë që i ka kaluar atij, trashëgimtarët e tjerë janë përgjegjës ndaj këtij trashëgimtari për diferencën mes vlerës aktuale të këtij sendi, të drejte, ose objekti dhe vlerës së prezumuar të tyre gjatë ndarjes.

144.2. E drejta e trashëgimtarit sipas paragrafit 1 mund të ushtrohet brenda 3 viteve nga data e ndarjes. Lidhur me parashkrimin e kësaj kërkesë zbatohen dispozitat e Ligjit të Detyrimeve. .

144.3. Sipas këtij Neni përgjegjësia e çdo trashëgimtari për çdo kërkesë kufizohet brenda kërkesës që i takon pjesës së tij në raport me trashëgiminë në tërësi.

### DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### PROCEDURA TRASHËGIMORE

##### Neni 145

Rregullat e procedurës sipas të cilave, gjykata, organet e tjera dhe personat e autorizuar vepronë në çështjet e trashëgimisë përcaktohen me dispozitat për procedurën jashtëkontestimore.

### ZBATIMI I LIGJIT TË TRASHËGIMISË I KOSOVËS

##### Neni 146

146.1. Dispozitat e këtij Ligji vlejné për trashëgiminë e të gjithë qytetarëve të Kosovës që në kohën e vdekjes kanë pasur vendbanimin në Kosovë, pavarësisht se ku ka ndodhur vdekja dhe ku gjendet pasuria.

146.2. Megjithatë, personat e përcaktuar në paragrafin 1 që nuk kanë vendqendrimin në Kosovë, mund të zgjedhin me testament ligjin e trashëgimisë së vendit ku ata kanë vendqendrimin tyre.

### LIGJI I TRASHËGIMISË PËR NJË PERSON QË NUK ËSHTË KOSOVAR

##### Neni 147

147.1. Trashëgimia e personave të tjerë rregullohet nga ligjet të vendit qytetar i të cilit ka qenë trashëgimlënësi në kohën e vdekjes.

147.2. Në qoftë se në shtetin e shtetasit të huaj të vdekur shqyrtohet pasuria trashëgimore e qytetarit të Kosovës sipas ligjeve të tij, pasuria trashëgimore e këtij shtetasi të huaj që ndodhet në territorin e Kosovës do të shqyrtohet sipas dispozitave të këtij ligji.

### KËRKESAT FORMALE PËR VLEFSHMËRINË E TESTAMENTEVE

##### Neni 148

148.1. Testamenti do të konsiderohet se i plotëson kërkesat formale të këtij Ligji, nëse plotëson njërën nga kërkesat formale:

a. Të ligjit të vendit ku trashëgimlënësi ka pasur shtetësinë në kohën e vdekjes, ose në kohën ku ai ka bërë testamentin,

b. Të ligjit të vendit ku është bërë testamenti,

c. Të ligjit të vendit ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin ose vendqendrimin, qoftë në kohën ku ai ka bërë testamentin ose në kohës e vdekjes së tij,

d. Të ligjit të aplikueshëm në vendin ku gjenden pasuritë e paluajtshme, por vetëm përse i përket këtyre paluajtshmërive ose,

e. Të ligjit për trashëgiminë në përgjithësi, ose që do të aplikohet për trashëgiminë e trashëgimlënësit në kohën kur ai ka bërë testamentin.



148.2. Paragrafi 1 aplikohet edhe për testamentet pas revokimit të një testamenti të mëparshëm.

148.3. Kërkesat në lidhje me kombësinë, shtetësinë, ose karakteristikat e tjera personale të trashëgimlënësit, apo të dëshmitarëve të testamentit do të konsiderohen “kërkesa formale” për qëllime të këtij neni.

## **HYRJA NË FUQI**

### **Neni 149**

149.1. Pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës ligji i dërgohet PSSP-së për t’u shpallur.

149.2. Ky ligj hyn në fuqi pas shpalljes nga PSSP-ja.

Më 4 shkurt 2005  
UNMIK/REG/2005/7

## Ligji Nr.2004 / 5

# PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

Kuvendi i Kosovës,

Duke bazuar në Rregulloren e UNMIK - ut, nr 2001/9 të dt. 15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, nenet 5.1 (ç), 5.7, 9.1.26 (a).

Me qëllim të krijimit të bazës ligjore për tregti me naftë dhe derivateve të naftës,

Miraton:

## LIGJIN PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

### QËLLIMI, ZBATIMI DHE FUSHËVEPRIMI

#### Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij Ligji është që të nxitet pjesëmarrja e konkurrencës së lirë dhe korrekte në sektorin e naftës në Kosovë; të sigurohet pagesa e të gjitha detyrimeve tatimore dhe fiskale mbi naftën dhe derivatet e naftës; të eliminohen sjelljet e paligjshme në sektorin e naftës; të ndihmojë në sigurimin e kualitetit, sigurisë, dhe sigurimin e furnizimit me derivate të naftës.

1.2. Ky Ligj do të zbatohet ndaj të gjithë personave të angazhuar në shitjen me shumicë, shitjen me pakicë, transportin dhe deponimin e naftës dhe derivateve të saj në Kosovë.

### PËRKUFIZIMET E TERMAVE

#### Neni 2

2.1. Secili prej termeve në vijim, kurdo që të përdoret në këtë Ligj, do të ketë kuptimin e dhënë, përveç nëse konteksti brenda të cilit një term i tillë paraqitet, nënkupton qartë diçka tjetër:

**Rezervat strategjike të derivateve të naftës** - sasi e derivateve të naftës të krijuara, të vendosura dhe të ruajtura në vende të caktuara, të cilat përdoren dhe shfrytëzohen për furnizim për nevoja dhe në rrethana të veçanta të parashikuara me ligj.

**Rezervat emergjente të derivateve të naftës** - sasi e derivateve të naftës të dedikuara për përdorim në raste të fatkeqësive të mëdha natyrore, shoqërore dhe katastrofave tekniko-teknologjike.

**Katastrofa teknologjike** - nënkupton ç'rregullimin e shkaktuar nga avaritë e mëdha të përmasave të sistemeve - sistemi elektroenergjetik, teknologjia informative, transporti etj, si dhe pasojat masive që dalin nga produktet jocilësore të derivateve të naftës.

**Këshill** - organ që do të themelohet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përgjegjës për rregullimin dhe vëzhgimin e sektorit të naftës në Kosovë.

**Shërbim profesional** - departament në kuadër të MTI-së i cili kryen punët administrative teknike edhe për Këshillin.

**Leje doganore**- autorizim zyrtar me shkrim, i lëshuar nga Shërbimi doganor për të lejuar importin ose eksportin e naftës dhe të derivateve të naftës.

**Shërbim doganor** - shërbim doganor i UNMIK-ut, i cili ka autoritet dhe përgjegjësinë e plotë për leje doganore, duke përfshirë autoritetin për vlerësim dhe mbledhje të detyrimeve doganore nga importuesit dhe eksportuesit e derivateve të naftës;

**Cilësi e karburanteve** - normë e përcaktuar nga organi kompetent lidhur me kualitetin, në përputhje me standardet e UE-së.

**Praktikë mashtruese tregtare** - fshehje, të përmbajturit ose heqja e çfarëdo prove materiale me qëllim të mashtrimit të konsumatorëve në lidhje me blerjen ose shitjen e derivateve të naftës.

**Licencë** - autorizim zyrtar me shkrim, i lëshuar nga Këshilli i paraparë me këtë Ligj, që përcakton rrethanat dhe kushtet në të cilat personat mund të marrin pjesë në veprimtaritë e përcaktuara dhe të autorizuara të sektorit të naftës në Kosovë.

**Person i licencuar** - person fizik ose juridik i cili ka fituar licencën për ushtrimin e veprimtarisë së shitjes me shumicë, shitjes me pakicë, transportimin, deponimin dhe veprimet tjera lidhur me tregtimin me derivate të naftës.

**Person fizik** - person fizik, ndërmarrje e regjistruar si biznes individual.

**Person juridik** - shoqëri akcionare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, ndërmarrje publike, organizatë dhe asociacion tjetër i regjistruar.

**Ministër** - ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

**Ministri** - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e themeluar në pajtim me Rregulloren nr. 2001/19 të UNMIK-ut.

**Naftë** - nafta e papërpunuar si hidrokarbur natyror dhe hidrokarburet tjera të papërpunuar.

**Derivatet e naftës** - benzinë, karburant dizel, auto dizel (vaj benzine) dizel industrial, lëndë djegëse për aviacion, vajguri, vaj lubrifikues, vaj motori, benzinë e lëngët, naftë, kundërngrirës, glicerinë për frerë, vaj i rëndë dhe prodhime tjera të tilla të identifikuar nga Këshilli me urdhëresë administrative, përveç asfaltit.

**Spektori i naftës** - biznesi me derivate të naftës në Kosovë.

**Shënim** - një bazë të dhënash të regjistruara nga Këshilli, të emrave, adresave, numrave identifikues të tatimpaguesve dhe nëse zbatohen, numrat e certifikatës së regjistrimit të aplikusve të evidencuar nga Këshilli.

**Shitës me shumicë** - person i cili blen derivate të naftës me qëllim të shitjes, ofrimit ose ndërmjetësimit në shitjen e derivateve të naftës për përdorim industrial, afarist ose të brendshëm, ose çdo person, përveç konsumatorit përfundimtar të derivateve të naftës.

**Shitës me pakicë** - person i cili blenë derivate të naftës me qëllim të shitjes ose ofrimit për shitje, personave të cilët janë konsumatorë përfundimtarë.

**Transporti** - bartja përmes gypave, hekurudhës ose automjeteve, përveç karburantit në rezervuarët e karburantit të trenit ose automjetit veprues dhe i shfrytëzuar posaçërisht për vënie në lëvizje të atij treni ose automjeti.

**Depo nafte** - hapësira, rezervuari sipas kushteve të parapara për deponim të derivateve, i dedikuar për nevoja vetjake prodhuese ose harxhuese dhe për qëllim të shitjes ose dhënies me qira.

**Rregullorja e UNMIK-ut 2002/5** - Rregullore e UNMIK-ut nr. 2002/5 e dt. 4 mars 2002, mbi ndryshimin e "Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Ekzekutivin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës", Neni 1.1(j) dhe Shtojca XI.

2.2. Siç është përdorur në këtë ligj, njëjisi nënkupton shumësin, dhe shumësi nënkupton njëjsin. Referimet ndaj "Nenit" janë referime të këtij Ligji përveç nëse është dhënë ndryshe.

## KRIJIMI DHE FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

### DISPOZITAT THEMELORE

#### Neni 3

3.1. Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve duke përfshirë edhe kryesuesin, tre (3) anëtarë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, një (1) nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe një (1) nga Ministria për Energjetikë dhe Miniera. Anëtarët e Këshillit propozohen nga

## LIGJI PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

Ministritë përkatëse dhe emërohen nga Qeveria. Gjithashtu duhet të merret në konsiderim dhe të sigurojnë një përbërje harmonike gjinore dhe etnike .

3.2. Anëtarët e Këshillit për punën e tyre nuk do të marrin pagë të rregullt, por mund t'u kompensohen shpenzimet në lartësi të mëditjes në Kosovë për pjesëmarrje në mbledhje të Këshillit.

3.3. Nëse anëtari i Këshillit ka ndonjë lidhje familjare ose personale me parashtruesin e kërkesës për licencim, përkatësisht vazhdim të licencës, shqyrtohet dhe vendoset lidhur me suspendimin ose revokimin e licencës ose ekziston ndonjë rrethanë tjetër e cila ndikon në paanësinë e anëtarit, anëtari shpall konfliktin e interesit dhe abstenon në shqyrtim dhe votim. Nëse në rast të një konflikti të interesit anëtari përkatës i Këshillit nuk deklarohet siç kërkohet me këtë ligj dhe ka marrë pjesë në marrje të vendimit, atëherë ky vendim i Këshillit është i pavlefshëm.

3.4. Mandati i anëtarëve të parë të Këshillit është:

- a). 4 vjet për kryesuesin;
- b). 3 vjet për dy anëtarë;
- c). 3 vjet për dy anëtarë.

3.5. Mandati i çdo anëtari pasues do të jetë katër vjet.

3.6. Çdo anëtar i Këshillit, përfshirë edhe ata të parët, mund të riemërohen edhe për një mandat shtesë katër vjeçar.

3.7. Anëtarët e Këshillit duhet të kenë kualifikime universitare dhe njohuri së paku në njërën nga këto lëmi: financa, juridike, planifikim urban, profile teknike dhe në standardet evropiane që i përkasin kësaj lëmie.

3.8. Anëtar i Këshillit nuk mund:

- a). të jetë zyrtari i Qeverisë ose zyrtari politik;

- b). të kryej punë për një ndërmarrje e cila ushtron veprimtari afariste në sektorin e naftës;
- c). të kryej ndonjë aktivitet tjetër që mund të rezultojë në konflikt interesash.

3.9. Anëtari mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit të tij/saj vetëm në rastet kur ai/ajo:

- a). parashtron dorëheqjen;
- b). bënë shkelje serioze të detyrave profesionale;
- c). është dënuar për një vepër penale në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër;
- d). nuk është në gjendje fizike apo mentale të kryej detyrat për tre muaj me radhë apo më shumë;
- e). vepron në kundërshtim me nenin 3.3 dhe me kushtet e parapara në nenin 3.11 të këtij ligji.

3.10. Këshilli ka për detyrë:

- a). që në bashkëpunim me departamentin përkatës të Ministrisë për Tregti dhe Industri të regjistroj të dhëna mbi personat që ushtrojnë veprimtari afariste në sektorin e naftës si dhe mbi personat të cilët kanë paraqitur kërkesë para Këshillit për lëshimin e një licence;
- b). të lëshojë, vazhdojë, suspendojë ose revojojë licencat në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
- c). të kërkojë nga personat e licencuar të mbajnë në dispozicion informacione që kanë të bëjnë me aktivitetet e tyre dhe t'i paraqesin Këshillit raporte mbi aktivitetet e tyre brenda afatit të caktuar nga Këshilli;
- d). të përkrahë konkurrencën dhe të pengojë sjelljet grabitçare ndërmjet personave të licencuar;
- e). të hetojë çfarëdo shkelje të dyshuar ose të parashikuar me këtë ligj ose me çfarëdo rregulle administrative dhe udhëzimi zbatues, të miratuar më vonë.

## LIGJI PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

3.11. Në përmbushjen e përgjegjësisë të veta, Këshilli do t'i drejtojë të gjitha aktivitetet dhe punët në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në mbledhje të Këshillit, të hapura për publikun. Të gjitha veprimet e Këshillit do të jenë:

- a) qartë të autorizuar dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji;
- b) qartë të lidhura dhe të nevojshme për arritjen e qëllimit të parashtruar;
- c) të zbatuara në mënyrë të tillë që krijojnë sa më pak raste për ndërhyrje në veprimet e Sektorit të naftës;
- d) në harmoni me çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare që është detyruese për Kosovën;
- e) në pajtim me Standardet Ndërkombëtare dhe Evropiane.

## LICENCIMI

## Neni 4

4.1. Asnjë person nuk mund të merret me transport, deponim ose shitje të derivateve të naftës, brenda kapaciteteve të shitjes me shumicë dhe pakicë, për qëllime afariste, pa një licencë aktuale valide, të lëshuar nga Këshilli.

4.2. Këshilli është i autorizuar që të kërkojë të dhëna nga aplikuesit për licenca të cilët mendojnë të marrin pjesë në Sektorin e naftës në Kosovë dhe të lëshojë këto licenca:

- a) në bashkëpunim me Autoritetin Doganor, licencën për import,
- b) licencën e përgjithshme për karburante, e cila autorizon pronarin të transportojë, deponojë dhe shes naftë dhe produkte të naftës,
- c) Licencën për transport të naftës dhe derivateve të saj,
- d) Licencën për deponim të naftës dhe derivateve të saj,
- e) Licencën për shitjen e naftës dhe të derivateve të saj,
- f) Licencën për shërbimet në sektorin e naftës përkitazi me transportin, deponimin dhe shitjen e vajrave lubrifikante, vajrave motor-

ike, antifrizit dhe vajrave për frerë.

4.3. Nuk do të ketë ndonjë kufizim të numrit të parashtruesëve të kërkesave për licenca të cilët do të regjistrohen ose të numrit të licencave të cilat mund të lëshohen nga Këshilli.

4.4. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, brenda 30 ditëve pas shpalljes së këtij ligji, do të nxjerrë një akt nënligjor i cili përcakton kushtet për shqyrtimin dhe vlerësimin e licencave.

4.5. Licenca vlenë dy vjet që nga data e lëshimit, por në pajtim me dispozitat e këtij ligji mund të suspendohet ose revokohet.

4.6. Personat e regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Kosovës, për ushtrimin e veprimtarisë nga sektori i naftës ose servisimin e automjeteve, shitja e të cilëve nuk kalon shumën e përgjithshme deri në 50.000 € në vit, mund të transportojnë dhe shesin vajra lubrifikuese, vajra motorike, antifriz dhe vaj frerësh, edhe pa u licencuar.

4.7. Licenca nënshkruhet nga ministri.

4.8. Licencat nuk mund t'u bartën personave të tretë.

## PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE KUSHTET PËR MIRATIM

## Neni 5

5.1. Ministri do të lëshojë Urdhëresën e Ministrisë për të përshkruar procedurat e sakta, të shkruara, jodiskriminuese për konkurrim, evidencim, shqyrtim, lëshim dhe përtrirje të licencave.

5.2. Lista e tarifave për lëshim dhe përtëritje të licencave është sa vijon:

- a) Importi i përgjithshëm 5.000 €,
- b) Importi i LPG (etan, etilen, butan, propan dhe kombinimet) 2.500 €,
- c) Importi i vajrave të rënda 2.000 €,
- d) Transporti i derivateve të naftës 2.000 €,
- e) Deponimi i derivateve të naftës 2.000 €,

## LIGJI PËR TREGTINË ME NAFTAË DHE DERIVATE TË NAFTAËS NË KOSOVË

- f) Shitja e derivateve të tjera nga gazrat dhe nafta 2.000 €,
- g) Shitja e LPG - (etan, etylen, butan, propan dhe kombinimet) 1.000 €,
- h) Shitja me shumicë e derivateve të naftës 3.000 €,
- i) Shitja me pakicë e derivateve të naftës 2.000 €,
- j) Licenca për shërbime 300 €,

5.3. Kërkesat për licencim do të bëhen me shkrim në një formular të përpiluar nga Këshilli. Këshilli do të vërtetojë kohën dhe datën e pranimit të secilës kërkesë për dhënie apo përtëritje të licencës.

5.4. Këshilli nëpërmjet Departamentit përkatës të MTI-së, do të evidencojë të dhëna në lidhje me secilën kërkesë për licencë nga Neni 4.2 të këtij Ligji.

5.5. Lidhur me kërkesën, Këshilli do të merr vendim për aprovim apo refuzim, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë, pas pranimit të kërkesës.

5.6. Këshilli do të miratojë kërkesën për licencë ose përtëritje të saj, nëse me dokumentacionin e parashtruesit të kërkesës bashkëngjiten:

- a) Kopja e vërtetuar e certifikatës së regjistrimit të biznesit;
- b) Kopja e vërtetuar e certifikatës së tatimpaguesit;
- c) Deklarata e vërtetuar përmes dëshmisë se: tërësisht e ka përmbushur obligimin e tij lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat;
- d) se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor;
- e) se nuk është dënuar për vepër penale me 6 muaj apo më tepër heqje lirie;
- f) se nuk i është suspenduar licenca apo revokuar, dy apo më shumë raste nga Këshilli;
- g) pagesa e nevojshme e taksës së parapare për licencim, dhe

h) në të njëjtën kohë me lëshimin e licencës, një sigurim të përgjegjësive ndaj palës së tretë në formë të polisës, valid gjatë tërë kohës së afatit të licencës, për incident në shumë

minimale prej pesëdhjetë mijë eurosh (50.000 €) dhe një premi totale prej një milion eurosh (1.000.000 €) për të gjitha rreziqet, kjo licencë të ju lëshohet kompanive të cilat kanë minimum e kapacitetit për deponim prej 1000 kubik për secilin produkt.

5.7. Nëse në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, Këshilli nuk merr vendim për licencim në përputhje me nenin 5.6 pika (a) deri në (d), parashtruesi i kërkesës konsiderohet i licencuar dhe do të ketë të drejtë të kërkojë që Këshilli së bashku me provat e siguruar, të parapara me nenin 5.6 nën (d), t'i lëshojë licencën e kërkuar. Këshilli do ta lëshojë licencën e tillë pa vonesë, nëse parashtruesi i kërkesës t'i përmbushë kërkesat e gjitha kushtet e parapara të Këshillit.

5.8. Si pjesë e procesit të licencimit, Këshilli është i autorizuar të kërkojë nga aplikuesi, informata të tilla që janë të arsyeshme për verifikimin e informatave të skeduar dhe informatave se a i plotëson konkuresi kushtet e parapara me dispozitat e këtij ligji.

## LICENCAT EKZISTUESE

## Neni 6

6.1. Licencat e lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vlejnjë katër (4) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, me kusht që i licencuari t'i plotësojë kushtet dhe kërkesat e parapara për licencë.

6.2. Të gjithë personat e licencuar brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, duhet të parashtrorjnë kërkesë për përtrirjen e licencës, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.

## PËRTËRITJA E LICENCËS

## Neni 7

7.1. Gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të afatit të një licence, Këshilli do t'i dërgojë personit të licencuar njoftimin me shkrim për këtë skadim. Çdo i licencuar që dëshiron të vazhdojë

ofrimin e shërbimeve të licencuara edhe pas afatit të licencës së parë, mund të përtërijë licencën e tij duke:

- a) e paguar në llogari të veçantë taksën për përtëritje të licencës në shumën prej pesëdhjetë eurosh (50 €) dhe
- b) duke i përmbushur obligimet nga Neni 5.6 pika d.

7.2. Për ripërtrirje të licencës, përsone i licencuar duhet t'i plotësojë kërkesat e Këshillit për licencim.

## SUSPENDIMI DHE REVOKIMI I LICENCAVE

### Neni 8

8.1. Në rast të suspendimit ose shuarjes së biznesit nga Regjistri i biznesit të Kosovës në mënyrë automatike shuhet edhe licenca e lëshuar nga Këshilli, (biznes joekzistues ose joligjor).

8.2. Këshilli është i autorizuar të suspendojë ose revokojë licencën, duke u bazuar në përcaktimin e fakteve, administrimin e parave dhe pas votimit me shumicë, konstatohet se:

- a) Personi i licencuar ka shkelur një dispozitë të këtij Ligji, rregullat e paraqitura në nenet vijuese, ose afatet dhe kushtet thelbësore të licencës;
- b) Personi i licencuar është vonuar më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë për të përmbushur detyrimet e tij tatimore, ose
- c) Personi i licencuar merret me praktika mashtruese tregtare.
- d) Nuk i është përmbajtur obligimit për sigurimin e rezervave emergjente.

8.3. Vendimi i Këshillit për të suspenduar ose revokuar një licencë do të bazohet vetëm në dëshmitë e prezantuara në seancën e shqyrtimit.

## RISHQYRTIMI DHE ANKESA NDAJ VENDIMEVE TË KËSHILLIT

### Neni 9

9.1. Personi i pakënaqur me vendimin e Këshillit, mundet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit t'i parashtrijë ankesë Ministrisë. Ankesa duhet të arsyetohet.

9.2. Ministria do të merr vendim në shkallën e dytë brenda 30 ditësh, të cilën do t'ia dërgojë paraqitësit të ankesës.

9.3. Kundër vendimit të shkallës së dytë mund të hapet kontesti administrativ.

## HARMONIZIMI ME BASHKËSINË EVROPIANE (BE)

### Neni 10

10.1. Për t'i mënjeluar ose zvogëluar pasojat negative të furnizimit jo të mjaftueshëm me derivate të naftës, në përputhje me standardet e BE-së, Këshilli do t'i rekomandojë ministrit mënyra alternative për të vendosur një rezervë strategjike të naftës.

10.2. Kualiteti i benzinës dhe dizel karburanteve:

a) Këshilli do t'i shqyrtojë dhe rekomandojë ministrit standardet për kualitet të benzinës dhe dizel karburantit në mënyrë që të zvogëlohen gazrat e dëmshme për ambientin që lëshohen nga automjetet dhe për të siguruar që Kosova të mos bëhet treg atraktiv për karburantet me specifikacion të ulët, të gjitha tipet e dizelit ose lëndëve të gasit mund të kenë në përbërjen e tyre maksimalisht 0,2% sulfur, benzina me plumb, përbërja e plumbit të jetë maksimalisht 0,15%.

b) Këshilli do t'i shqyrtojë dhe rekomandojë ministrit standardet e arritura për kualitetetin e karburanteve sipas standardeve të BE-së, në një periudhë kohore që është në përputhje me zhvillimin e Kosovës.

LIGJI PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

**REZERVAT EMERGJENTE DHE OPERATIVE**

**Neni 11**

11.1. Ministria përkujdeset, mbikëqyrë dhe është përgjegjëse për furnizim të sigurtë, të rregullt dhe cilësor me derivate të naftës.

11.2. Rezervat strategjike të derivateve të naftës përcaktohen si stoqe intervenimi në rast të fatkeqësive elementare, epidemive ose katastrofave teknologjike.

11.3. Poseduesit e licencës së përgjithshme dhe asaj për deponim të derivateve të naftës janë të obliguar që çdoherë t'i sigurojnë pesë (5) % nga kapaciteti i tyre për rezerva emergjente deri në krijimin e rezervave materiale të Kosovës.

11.4. Marrëdhëniet ndërmjet personit të licencuar dhe Ministrisë përkitazi me rezervat konkrete emergjente përcaktohen me kontratë, e cila nënshkruhet me rastin e licencimit dhe vlenë aq kohë sa edhe licenca.

11.5. Qeveria e Kosovës mund të caktojë mënyra alternative për të krijuar një rezervë strategjike të naftës.

11.6. Ministri do të përcaktojë mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të rezervave emergjente dhe regjionalizimin e tyre.

11.7. Furnizuesit me naftë dhe shfrytëzuesit, për elektrana, ngrohtore të qyteteve, transportin publik dhe furra të bukës, janë të obliguar që të sigurojnë rezerva operative, në sasi të shpenzimit mesatar gjatë pesëmbdhjetë (15) ditësh në vitin paraprak, me kusht që në atë vit të kenë harxhuar së paku njëzet e pesë (25) tonë naftë.

**PRAKTIKAT MASHTRUESE TREGTARE**

**Neni 12**

12.1. Të licencuarit nuk do të ndërmarrin asnjë veprim lidhur me deponimin, reklamimin, ofertën dhe shitjen e derivateve të naftës në Kosovë, me qëllim që të mashtrojnë, tentojnë

të mashtrojnë ose që ka efekte të mashtrimit, ndaj blerësit ose shfrytëzuesit lidhur me:

- a) prejardhjen e derivateve të naftës,
- b) emërtimin e produktit të derivateve të naftës,
- c) emrin ose identitetin e shitësit,
- d) çmimin e derivateve të naftës, dhe
- e) përbërjen, cilësinë dhe sasinë e naftës ose derivateve të naftës.

12.2. Të licencuarit nuk do të mbajnë, ofrojnë për shitje ose shesin çfarëdo lloj derivati të naftës, prej asnjë kontejneri, rezervoari, pompe ose ndonjë mjeti tjetër shpërndarës, përveç atyre të prodhuara dhe furnizuara nga prodhuesi ose furnitori përkatës sipas emrit, shenjës tregtare, simbolit, mbishkrimit ose tipareve tjera të ndryshme nga ato që gjenden në rezervoar, kontejner, pompë ose pajisje tjera të cilat janë prezente me rastin e shitjes, ofertës për shitje ose shpërndarjes.

12.3. Të licencuarit nuk do të përdorin mjete matëse jo të sakta.

12.4. Të licencuarit nuk do t'i qasen një praktike që kërkon licencë pa pasur më parë një licencë përkatëse nga Këshilli.

12.5. Të licencuarit që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij Neni, do të konsiderohet se kanë ushtruar një praktikë mashtruese tregtare.

**INTERVENIMI I GJYKATËS**

**Neni 13**

13.1. Përveç dënimeve dhe dispozitave tjera detyruese nga ky Nen, Këshilli, me pajtimin e ministrit, mund të kërkojë nga gjykata kompetente që të lëshojë urdhër për pezullim dhe ndërprerje të veprimtarisë, nëse personi ka bërë shkelje të këtij Ligji apo të dispozitave tjera të miratuara më vonë.

13.2. Përveç dënimeve dhe dispozitave tjera detyruese në fuqi sipas këtij Neni, Këshilli



mundet, me kërkesën e ministrit, të kërkojë nga gjykata kompetente që menjëherë të ndalë shitjen momentale ose të ardhshme nga një pompë ose pajisje tjetër shpërndarëse prej të cilës nafta dhe derivatet e naftës janë ofruar për shitje në kundërshtim me këtë Ligj.

13.3. Përveç dënimeve dhe dispozitave detyruese në fuqi sipas këtij neni, Këshilli mundet, me pëlqimin e ministrit, të kërkojë nga Gjykata kompetente që të ndalojë një person që të merret me praktika mashtruese tregtare.

## ZBATIMI

### Neni 14

14.1. Ministria do të lëshojë urdhëresë dhe udhëzime për zbatimin e këtij Ligji.

14.2. Mbikëqyrjen administrative të zbatimit të këtij Ligji e bën Ministria,

14.3. Inspektimin e bën inspekcioni kompetent dhe organet e autorizuara me këtë dhe ligje tjera.

14.4. Këshilli do të ketë autoritetin që të zbatojë çdo dispozitë të këtij Ligji në rastet kur mendohet se është bërë shkelje administrative. Këshilli mund të bashkëpunojë me Shërbimin Policor të Kosovës ose agjensionet tjera, në bazë të Ligjit për ndihmë, lidhur me zbatimin e ligjshmërisë me rastin e shkeljeve administrative dhe do të ndërmerr masa të përfshirjes së organit të autorizuar ligjor për ruajtjen e qetësisë, parandalimin e prishjes së qetësisë ose ndërmarrjen e masave përkatëse në rast se prishet qetësia.

14.5. Shërbimi Policor i Kosovës dhe agjensionet tjera të autorizuara janë kompetente që të zbatojnë çfarëdo dispozite të këtij Ligji në rastet kur mendohet të jetë kryer ndonjë vepër kriminale.

14.6. Këshilli, në rast kërkesë, do t'i ofrojë çfarëdo informate relevante që ka Zyrës për Krim të Organizuar në Kosovë, Njësisë Qendrore

për Hetimin e Kriminalitetit, Njësisë Sekrete për Krime, Shërbimit Doganor dhe cilëso njësie tjetër hetuesie të autorizuar, pa vendim paraprak të Gjykatës.

## DISPOZITAT NDËSHKUESE

### Neni 15

15.1. Me gjobë deri në 100.000 € ndëshkohet personi i cili zhvillon veprimtarinë pa licencë paraprake.

15.2. Me gjobë deri në 50.000 € ndëshkohet personi që e ka licencën, në qoftë se bën mashtrim lidhur me prejardhjen e naftës dhe derivateve të saj,

15.3. Me gjobë deri në 50.000 € ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse përdorë emërtim tjetër të produktit të naftës dhe derivateve të saj.

15.4. Me gjobë deri në 50.000 € ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse bën mashtrim lidhur me emrin dhe identitetin e shitësit.

15.5. Me gjobë deri në 30.000 € ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse bën mashtrim me çmimin e naftës dhe derivateve të saj.

15.6. Me gjobë deri në 30.000 € ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse bën mashtrim me cilësinë dhe sasinë e naftës dhe derivateve të saj.

15.7. Me gjobë prej 50.000 € ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse përdorë njësi dhe stabilimente matëse të pacertifikuara.

15.8. Me gjobë deri në 50.000 € ndëshkohet edhe përgjegjësi i personit që e ka licencën, nëse në forma të palejueshme ndotë ambientin ku vepron.

15.9. Nëse ndodhë gjoba e dytë, atëherë vlera e saj do të dyfishohet dhe do të inicohet procedura për vepër penale.

LIGJI PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

15.10. Ministri përshkruan formën e licencës, përbërjen e saj, procedurat dhe shpenzimet për nxjerrjen e saj, çmimi për lëshimin e licencës dhe tarifa prej 100 E për secilin kamion i cili kalon kufirin dhe i cili importon produkte të naftës në territorin e Kosovës. Për shkak të ndjeshmërisë sociale vetëm gasi dhe mazuti të përjashtohen nga kjo ekstra tarifë.

15.11. Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave të këtij Ligji derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

**DISPOZITAT KALIMTARE DHE  
PËRFUNDIMTARE**

**Neni 16**

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja.

Më 7 maj 2005  
UNMIK/REG/2005/22

## Ligji Nr. 2004/1 PËR TRANSPORTIN RRUGOR

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nr. 2001/9 të 15 majit, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, veçanërisht Kreu 5.1(h), 5.7, 9.1.26 (a), 9.3.3 dhe

Më qëllim të përcaktimit të parimeve me të cilat rregullohen kushtet dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë së sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, të harmonizuara me përvojat më të mira ndërkombëtare.

Miraton:

### LIGJIN PËR TRANSPORTIN RRUGOR

#### KREU I DIZPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

#### LËNDA E RREGULLIMIT

Me këtë Ligj rregullohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.

##### Neni 2

#### FUSHA E ZBATIMIT

2.1. Ky Ligj zbatohet në transportin rrugor të udhëtarëve dhe transportin rrugor të mallrave, në rrugët publike të Kosovës.

2.2. Gjithashtu ky Ligj zbatohet në transportin rrugor të udhëtarëve dhe transportin rrugor të mallrave jashtë Kosovës në tërësi apo pjesërisht nga ana e operatorëve të themeluar në Kosovë.

##### Neni 3

#### PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij Ligji termat e mëposhtme kanë këto kuptime.

“**Transport publik**”: transporti që me kushte të njëjta është i përshtatshëm për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit.

“**Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit (Ministria)**”: njësi administrative përgjegjëse për çështje të cilat kanë të bëjnë me sektorin e transportit të themeluar në pajtim me Rregulloren nr. 2001/19 të 13 shtatorit mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

“**Komuna**”: njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Rregullosës së UNMIK-ut 2000/45.

“**Licencë**”: e drejta për të kryer veprimtari transporti të rregullt të udhëtarëve apo të mallrave.

“**Leje**”: dokumenti me të cilin lejohet kryerja e transportit për në, dhe jashtë Kosovës, të udhëtarëve apo të mallrave.

“**Operator i transportit**”: personi juridik a fizik, i cili ushtron veprimtarinë e transportit publik.

“**Operator vendës**”: operatori i transportit me seli në territorin e Kosovës.

“**Operator i jashtëm**”: operatori i transportit me seli jashtë territorit të Kosovës.

“**Drejtues automjeti**”: personi, i cili ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjeti motorik.

“**Transport i brendshëm**”: transporti në territorin e Kosovës.

“**Transport i jashtëm**”: transporti ndërmjet Kosovës dhe një apo më shumë vendesh.

“**Transport i rregullt udhëtarësh**”: shërbim i rregullt transporti në itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë, shërbim i cili kryhet vetëm me autobus dhe mund të jetë urban, ndër-urban dhe i jashtëm.

“**Transporti i lirë udhëtarësh**”: transport udhëtarësh jashtë shërbimit të rregullt, duke përfshirë shërbimet speciale të rregullta, që bartin grupe udhëtarësh të organizuar me iniciativë të konsumatorit ose vetë bartësit.

## LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

**“Transport në llogari të vetë”:** transporti i mallrave me automjet transporti, në ardhje apo në kthim vetëm për llogari të vet.

**“Rrugë publike”:** rruga magjistrale, regjionale ose lokale me të drejtë të drejtimit për trafik publik.

**“Auto-taksi”:** Transporti jashtë linjor i udhëtarëve i cili kryhet me automjete të udhëtarëve dhe i cili plotëson standardet sipas këtij Ligji.

**“Stacioni i autobusëve”:** Objekti i licencuar nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit që të ofroj shërbime të rregullta për operatorët transportues dhe udhëtarët.

**“Vend-ndalim”:** lokacioni i sinjalizuar ku u mundësohet ndalja autobusëve për të zbritur dhe marrë udhëtarët.

**“Fletudhëtim”:** dokumenti i udhëtimit të automjetit që mund të kryej transportin e udhëtarëve në rrugë.

**“Udhëtar”:** personi i cili në bazë të kontratës ka të drejtë transporti.

**“Linjë”:** përmbledhja e nisjeve nga pikënisja deri në pikërritjen e stacionit të autobusëve, gjegjësisht në vendndalime ku transportohen udhëtarë ose mallra sipas rendit të publikuar dhe të regjistruar në një apo më shumë nisje në atë relacion.

**“Linjë direkt”:** linja e cila në rendin e udhëtimit nuk përmban asnjë vend-ndalje por vetëm pikën e nisjes dhe të mbarimit.

**“Linjë ekspresë”:** linja e cila në rendin e udhëtimit përveç pikës së nisjes dhe të mbarimit përmban një vend-ndalje.

**“Linjë e udhëtarëve”:** linja e cila në rendin e udhëtimit përveç pikës së nisjes dhe të mbarimit përmban dy e më shumë vend-ndalje.

**“Relacion”:** distanca në mes dy vendeve në linjë të cilat në rendin e udhëtimit janë të regjistruara si stacione të autobusëve.

**“Tarifë”:** akti i cili përmban çmimin lidhur me transportin dhe kushtet tjera transportuese.

**“Rend i udhëtimit”:** akti i cili përmban emrin e kompanisë transportuese, korridorin në të cilin kryhet transporti, llojin e linjës, renditjen e stacioneve të autobusëve apo vendbanimeve, si dhe distancën nga pikënisja apo stacioni ku fillon, kohën e nisjes dhe arritjes nga stacionet e autobusëve gjegjësisht nga vendbanimet, mbikëqyrjen e mbajtjes së linjës në atë korridor si dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

**“CEMT”:** (Konferenca Evropiane e Ministrave të Transportit): leje multilaterale për kryerjen e transportit të mallrave.

**“Fletë ngarkesë”:** akti që përcjellë mallin i cili përmban: datën dhe vendin e dhënies, emrin e mbiemrin apo titullin e dërguesit dhe adresën e tij, emrin e mbiemrin apo titullin e marrësit dhe vendin e shkarkimit, shenjën e sasisë dhe të llojit të mallit, regjistrimin e dokumenteve që i bashkëngjiten fletëngarkesës, shpenzimet e transportit e të tjera.

**“Transport urban”:** Transporti i ushtruar brenda kufijve urban të komunës.

**“Transporti urban-periferik”:** transport i ushtruar brenda territorit të komunës.

**“Vozitje shtesë”:** (bis-vozit).

## ROLI I MINISTRISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

### Neni 4

4.1. Ministria nëpërmjet Ministrit, përcakton politikën dhe strategjinë e zhvillimit të transportit rrugor dhe bënë rregullimin e sektorit të transportit në Kosovë.

4.2. Në lëmin e sektorit të transportit Ministri:

a) i propozon Qeverisë strategjinë e zhvillimit të transportit dhe ligjet që rregullojnë veprimtarinë e transportit.

b) Miraton procedurat për dhënien e licencave

dhe lejeve për ushtrimin e veprimtarisë së transportit.

c) i propozon Qeverisë ngritjen e normave siguruese, ekologjike e teknike në transportin rrugor dhe mbrojtjen ekologjike të hapësirës së Kosovës.

4.3. Në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Ministri i arrin dhe finalizon marrëveshjet në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të jashtëm në fushën e transportit.

#### Neni 5

Ministria do të lëshon rregulla në lidhje me operimin e shërbimeve të autobusëve nga ana e drejtuesve të transportit rrugor të udhëtarëve, si vijon:

a) Drejtimin e shërbimit të autobusëve duke përfshirë:

- Sigurinë e udhëtarëve dhe publikut;
- Kualifikimet, trajnimi, përvoja e shoferëve të autobusëve dhe njerëzve të tjerë që ofrojnë shërbime në emër të drejtuesve për shërbim me autobus;

- Koha maksimale e minimale e vozitjes dhe koha e pushimit të shoferëve të autobusit:

- Sigurimi;
- Lëshimi i biletave të udhëtarëve;
- Ankesat e konsumatorëve dhe informacionet;

b) Përgatitja, publikimi dhe përputhshmëria e orareve për shërbimet e rregullta linjore;

c) Obligimet e shoferëve të autobusëve publik dhe njerëzit e tjerë që ofrojnë shërbime në emër të drejtuesve të transportit rrugor të udhëtarëve;

d) Mirëmbajtja dhe pastrimi i autobusëve publik;

e) Mirëmbajtja, parkimi dhe objektet tjera për autobusët publik;

f) Krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre;

g) Auditimi (kontrollimi) i regjistrave dhe sistemeve.

#### Neni 6

Komuna:

a) përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit të sigurta, efikase dhe ekonomike përbrenda kufijve të komunës;

b) nxjerr planin e transportit lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës;

c) ndryshon atë plan jo më vonë se pesë vite nga data e nxjerrjes së tij;

d) plani duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë;

e) publikon planin apo planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë.

#### Neni 7

Komuna mund të nxjerr rregulla lidhur me veprimin e autobusëve me kusht që këto rregulla të mos paragjykojnë të drejtat dhe interesat e asnjërës prej bashkësive, të cilat respektohen mirëfilli. Këto rregulla përfshijnë:

a) Rregullimin ose ndalimin e përdorimit të autobusëve publik në rrugë të caktuara ose rajone që kanë lidhje me rrugë;

b) Marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin e udhëtarëve;

c) Krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre;

d) Transporti i bagazhit të udhëtarëve ose mallrave tjera;

e) Rregullimin ose ndalimin e transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë.

f) Shpejtësia maksimale e autobusëve publikë;

g) Dizajni, pajisja, mjetet (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publik;

h) Pikat e stacioneve dhe vend-ndaljet në linjat për autobus; dhe

i) Rregullimin ose ndalimin e shpalljeve, shenjave dhe reklamave brenda apo jashtë autobusëve publikë.

## LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

### Neni 8

Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transporti në nga dhe nëpër territorin e Kosovës janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij Ligji.

a) Të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt.

b) Të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese.

c) Të plotësojnë evidenca statistikore sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Përmbajtja, mënyra e regjistrimit, mënyra e raportimit dhe afatet përcaktohen me akt të veçantë nënligjor.

d) Në automjet transportues duhet të jenë dokumentet përkatëse sipas këtij Ligji.

### Neni 9

9.1. Transporti rrugor me vendet tjera bëhet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, të marrëveshjeve dhe rregullave tjera ndërkom-bëtare.

9.2. Në qoftë se nuk është lidhur marrëveshja bilaterale me vende tjera, transporti ndërmjet Kosovës dhe atyre vendeve bëhet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, sipas rregullit me kusht reciprociteti.

### Neni 10

Operatori i transportit i cili bën transportin e rregullt publik në pajtim me kushtet dhe kapacitetet disponuese të automjeteve duhet të marrë përsipër për transportim çdo udhëtar apo mall të cilët sipas rregullave të veçanta nuk janë të përjashtuara nga transporti.

### Neni 11

11.1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, kryhet mbi bazën e licencës. Miratimi i saj në emër të operatorit bëhet nga Ministri.

11.2. Licenca është e patjetërsueshme dhe e pa transferueshme.

11.3. Transporti rrugor i jashtëm i udhëtarëve dhe mallrave bëhet në bazë të licencës dhe lejes që e lëshon Ministri.

11.4. Kriteret, rregullat dhe dokumentacioni për dhënien e licencës dhe lejes përcaktohen me akt të veçantë juridik që e nxjerr Ministri.

### Neni 12

Licencat dhe lejet jepen kundrejt pagesës. Tarifat përcaktohen nga Ministria për Transport dhe Postë-Telekomunikacion, në bashkëpunim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa.

### Neni 13

Ministria do të mbajë:

a) një regjistër dhe një kopje të të gjitha licencave dhe lejeve të operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve;

b) një regjistër dhe një kopje të licencave dhe lejeve të operatorëve të transportit rrugor të mallrave.

### Neni 14

14.1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve nuk mund të ushtroj veprimtarinë para se të pajiset me licencë, leje dhe rend të udhëtimit.

14.2. Licenca është e domosdoshme për këto raste:

- a) transport të rregullt të udhëtarëve
- b) transport taksi
- c) transport të mallrave
- d) stacione të autobusëve
- e) terminale të mallrave (stacione të ngarkesave).

14.3. Transportuesi i cili posedon licencë për transport publik të rregullt të udhëtarëve dhe mallrave, nëse dëshiron të ushtroj veprimtarinë e transportit jashtë Kosovës duhet të pajiset me leje të veçantë.

14.4. Licencat, lëshohen për një periudhë kohore 5- vjeçare.

14.5. Licenca, sipas paragrafit 2 të këtij Neni nuk është e nevojshme për automjetet e TMK-së, KFOR-it, SHPK-së, ndihmës së shpejtë dhe zjarrfikësve.

#### Neni 15

Kriteret bazë për dhënien e licencës (lejes në transportin e jashtëm) janë:

- a) Kompetenca profesionale;
- b) Reputacioni i mirë;
- c) Besueshmëria financiare;
- d) Gjendja e rregullt teknike e mjeteve të transportit.

#### Neni 16

Ministri përshkruan formën e licencave, përm-bajtjen, procedurat dhe shpenzimet e lëshuar-rjes së tyre, mënyrën e mbajtjes së evidencës si dhe kushtet e veçanta për lloje të ndryshme të transportit.

#### Neni 17

17.1. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit humb vlerën kur:

- a) vdesë apo humb zotësinë për të vepruar mbajtësi i saj;
- b) mbaron afati i dhënies së saj.

17.2. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit hiqet nga organi që e lëshon atë kur:

- a) kërkohet nga mbajtësi i saj;
- b) veprimtaria nuk fillon në kohën e përcaktuar në të;
- c) mbajtësi i licencës apo lejes nuk plotëson një apo më shumë nga kriteret e nenit 15 të këtij Ligji.
- d) mbajtësi i licencës apo lejes shkel detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj.

## KREU II

### TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

#### Neni 18

18.1. Transporti rrugor i udhëtarëve ushtrohet si:

- a) Transport i rregullt i udhëtarëve me

autobus

b) Transport i lirë i udhëtarëve me autobus; dhe

c) Transport taksi i udhëtarëve

18.2. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus ushtrohet si:

a) Transport urban i udhëtarëve me autobus

b) Transport ndër urban i udhëtarëve me autobus;

c) Transport jashtë Kosove i udhëtarëve me autobus.

18.3. Transporti i rastit i udhëtarëve me autobus ushtrohet si transport i rastit ndër urban dhe transport i rastit jashtë Kosove.

#### Neni 19

19.1. Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e:

a) Transportit ndër urban të udhëtarëve me autobus;

b) Transportit të lirë të udhëtarëve me autobus;

c) Transportit jashtë Kosove të udhëtarëve me autobus.

19.2. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobus dhe transportit taksi të udhëtarëve.

#### Neni 20

Ministria mund të krijoj një trup rregullues përgjegjës për koordinimin e transportit të udhëtarëve me autobus. Përbërjen, të drejtat dhe obligimet i përcakton Ministri me akt të veçantë juridik.

## 1. TRANSPORTI I RREGULLT I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

#### Neni 21

21.1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus, kryhet në relacionet e caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit të përcaktuar dhe vërtetuar më parë, çmimit të caktuar e të shpallur

## LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

dhe kushteve tjera të transportit.

21.2. Transporti i rregullt i udhëtarëve mund të ushtrohet si transport direkt, ekspres dhe i udhëtarëve.

21.3. Linjat ndër urbane janë ato linja të cilat zhvillohen në rrugët magjistrale dhe rajonale të Kosovës dhe lidhin dy apo më shumë komuna.

21.4. Linjat brenda dhe jashtë , janë ato linja të cilat pikën fillestare e kanë në Kosovë ndërsa atë përfundimtare jashtë territorit të Kosovës.

21.5. Linjat komunale janë ato linja të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në kuadër të territorit të një komune.

2. Transporti i rregullt i brendshëm i udhëtarëve me autobus

### Neni 22

22.1. Transporti i rregullt i brendshëm i udhëtarëve me autobus, ushtrohet si transport urban dhe ndër urban.

22.2. Transporti i rregullt urban i udhëtarëve me autobus, si transport i udhëtarëve në qarkullimin rrugor publik, rregullohet me akt të veçantë juridik që e nxjerr Komuna.

22.3. Rrjeti i linjave urbane dhe numri i orareve në to miratohet nga komuna.

22.4. Rrjeti i linjave ndër urbane dhe numri i orareve në to miratohet nga Ministri.

22.5. Dy komuna mund të arrijnë marrëveshje për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve në mes veti. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse aprovohet nga MTPT.

22.6. Transporti i rregullt i brendshëm i udhëtarëve ushtrohet edhe si transport i veçantë i rregullt i udhëtarëve.

### Neni 23

23.1. Rendi i udhëtimit sipas këtij Ligji është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt

në transportin rrugor i cili përmban:

- emrin e transportuesit
- relacionin
- llojin e transportit
- radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare
- kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje
- periudha kohore në të cilën mbahet linja
- afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

23.2. Rendet e udhëtimit vlejnë një vit.

23.3. Kriteret, mënyra dhe procedura e regjistrimit, vërtetimit, revokimit dhe riregjistrimit të rendeve të udhëtimit si dhe caktimi i tarifave për to rregullohet me akt të veçantë juridik që e nxjerr Ministri.

23.4. Regjistrimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit e bën MTPT-ja.

23.5. MTPT-ja mban regjistrin e rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe regjistruar.

### Neni 24

24.1. Transportuesi është i obliguar që transportin ta kryen në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe regjistruar.

24.2. Transportuesi mund që në një pjesë apo tërë linjën të ushtroj transportin edhe me më shumë automjete (bis-voztje) sipas rendit të regjistruar dhe vërtetuar të udhëtimit.

24.3. Transportuesi është i obliguar që stacioneve të autobusëve nëpër të cilat kalon t'ua dërgojë rendin e udhëtimit së paku 5 ditë para ditës së fillimit të operimit sipas rendit të udhëtimit.

### Neni 25

25.1. Transportuesi, duhet ta filloj veprimtarinë e transportit të rregullt publik të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit dhe atë nuk mund ta ndërpres përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.

25.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij Neni,



transportuesi mund përkohësisht të ndërpres veprimtarinë si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat e pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt.

25.3. Për ndërprerjen nga paragrafi 2 i këtij Neni, transportuesi është i obliguar që të informoj organin i cili e ka vërtetuar rendin e udhëtimit i cili organ do të lëshojë një vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.

25.4. Transportuesi nuk mund ta ndërpret (pezulloj) veprimtarinë e transportit të rregullt në linjë sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar pa lejen e organit që e ka lëshuar atë rend të udhëtimit.

#### Neni 26

26.1. Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet e as të jepet me qira.

26.2. Transferimin e rendit të udhëtimit e bënë vetëm organi që e ka lëshuar atë.

26.3. Emri i transportuesit i shënuar në rendin e udhëtimit duhet të jetë i njëjti me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe dokumenteve tjera përcjellëse të autobusit.

#### Neni 27

27.1. Rendi i udhëtimit do të revokohet nga organi që e ka lëshuar atë në kushtet kur:

- a) në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit nuk ia fillon veprimtarisë;
- b) brenda një muaji kalendarik pa miratimin e organit që e ka lëshuar atë nuk e mban nisjen 3 herë;
- c) bën ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes respektivisht kur 12 herë brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit nuk e mban nisjen pa miratimin e organit që e ka vërtetuar atë.

27.2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjta, kur i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

27.3. Vendimet i merr organi që e ka vërtetuar

atë pas dëshmisë së inspektorit të transportit pranë MTPT-ës.

27.4. Operatori i transportit ka për detyrë që, ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtim të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit në linjën e lejuar, ta shpallë me anë të shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

#### Neni 28

28.1. Transportuesi përcakton çmimoren. Çmimorja duhet të vendoset në autobus i cili qarkullon në atë linjë.

28.2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimoreve nga paragrafi 1 i këtij Neni.

#### Neni 29

29.1. Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me biletë. Bileta mund të blihet në autobus, stacion, njësi afariste, agjencion apo vende tjera tek të cilat transportuesi ka besuar shitjen e biletave.

29.2. Bileta duhet të përmbajë:

- relacionin
- çmimin
- numrin serik
- emrin e kompanisë
- datën dhe kohën e nisjes.

29.3. MTPT-ja në bashkëpunim me MEF-ja do të përshkruan rregullat mbi evidencën e biletave.

#### Neni 30

30.1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuar udhëtarësh duke përjashtuar udhëtarët tjerë në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti:

- nxënësve të shkollave fillore nga vendbanimi deri të shkolla dhe anasjelltas;
- punëtorëve nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas.

## LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

30.2. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:

- relacionin
- listën e udhëtarëve
- çmimin e transportit
- vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve
- kohën gjatë së cilës kryhet transporti.

30.3. Kontratën e bënë transportuesi paraprakisht i licencuar nga MTPT dhe porositi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve ku porositi është njëkohësisht edhe pagues i transportit.

30.4. Lejen për transport sipas këtij Neni e lëshon organi kompetent komunal nëse transporti kryhet brenda një komune respektivisht MTPT-së nëse ky transport kryhet në territorin e dy e më tepër komunave.

30.5. Lejet sipas këtij Neni nuk përmbajnë rendin e udhëtimit dhe çmimoren e përcaktuar sipas këtij Ligji.

30.6. Ne autobus në pjesën e përparme në vend të dukshëm duhet të jetë mbishkrimi "Transport i veçantë".

### 3. TRANSPORTI I RREGULLT I UDHËTARËVE JASHTË KOSOVËS

#### Neni 31

Transporti i jashtëm i udhëtarëve me autobus, ndërmjet Kosovës e shteteve tjera dhe transporti transit nëpërmjet territorit të Kosovës, bëhet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, të marrëveshjeve dhe rregullave tjera ndërkombëtare, e mbi bazë të pëlqimit paraprak të Ministrisë dhe UNMIK-ut dhe të organeve kompetente të shteteve të tjera.

#### Neni 32

32.1. Leja, nga Neni 11 paragrafi 3 i këtij Ligji, jepet me kërkesë të operatorit të transportit të interesuar vendës apo të jashtëm.

32.2. Kërkesën, nga paragrafi 1 i këtij Neni duhet paraqitur Ministrisë. Kërkesës duhet bashkëngjitur të gjitha dëshmitë mbi plotësi-

min e kushteve të përcaktuara me këtë Ligj dhe akte tjera normative.

32.3. Operatori i jashtëm paraqet kërkesë për t'iu dhënë leja, përmes organit kompetent të shtetit, në të cilin e ka selinë.

32.4. Transporti brenda territorit të Kosovës nga operatorët e transportit rrugor që nuk e kanë selinë në Kosovë është i ndaluar. Përgjashtimet bëhen vetëm me leje të dhënë nga Ministri, duke i marrë parasysh të drejtat dhe interesat e Bashkësive. Vendimet për dhënien e lejes për operatorë transporti që nuk kanë zyrën kryesore në Kosovë, duhet të merren nga Ministri në bashkërendim me UNMIK-un.

32.5. Regjistrin e lejeve për operim jashtë Kosovës, hyrje në Kosovë dhe kalim transit nëpër territorin e Kosovës e mban Ministria.

32.6. Formën, përmbajtjen, afatin dhe elementet tjera të lejes i përcakton Ministri në bashkëpunim me UNMIK-un.

#### Neni 33

Operatori vendas ka për detyrë që, për çdo tremujor, t'ia dërgojë Ministrisë të dhënat për numrin e udhëtimeve të bëra dhe të udhëtarëve të transportuar në njërin dhe në drejtimin tjetër, më së voni në afat 15 ditësh nga dita e kalimit të tremujorit për të cilin paraqitet raporti.

### 4. TRANSPORTI I LIRË I UDHËTARËVE

#### Neni 34

34.1. Transport i lirë i udhëtarëve, në qarkullimin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, është transporti i grupit të njohur që më parë, pa hyrje dhe dalje të udhëtarëve rrugës, për të cilin relacioni, çmimi i transportit dhe kushtet e tjera përcaktohen me kontratë ndërmjet operatorit të transportit dhe porositisit të transportit.

34.2. Transporti, nga paragrafi 1 i këtij Neni, mund të bëhet si i kohëpaskohshëm.

34.3. Transport i lirë i udhëtarëve është edhe transporti-taksi dhe me automjete tërheqëse për qëllime turistike.

#### Neni 35

Transport i kohëpaskohshëm, në pajtim me këtë Ligj, është:

a) “transport qarkor” me dyer të mbyllura (dalja në piknik, udhëtimi turistik etj.), që filon dhe mbaron në vendnisje, me ç’ rast grupi i njëjtë i udhëtarëve transportohet me të njëjtin autobus në mbarë rrugën,

b) transporti që përbëhet nga udhëtimi me automjet të plotë në shkuarje dhe nga udhëtimi me automjet të zbrazët në kthim,

c) transporti që përbëhet nga udhëtimi me automjet të zbrazët në shkuarje dhe nga udhëtimi me automjet të plotë në kthim,

d) transporti i grupeve të udhëtarëve të organizuara paraprakisht në shumë udhëtime nga vendnisja e njëjtë e deri të vendarritja e njëjtë. Çdo grup udhëtarësh, i cili ka bërë një udhëtim në shkuarje, kthehet në vendnisje me ndonjë ngasje të mëvonshme automjeti. Udhëtimi i parë në kthim dhe i fundit në shkuarje, bëhet me automjet të zbrazët.

e) transportet e tjera të kohëpaskohshme.

#### Neni 36

36.1. Transportin e lirë të udhëtarëve nga Neni 35 nën (a) transportuesi nuk ka nevojë për leje të veçantë, ndërsa në të njëjtin nen ,nën (b) (c) (d) dhe (e) është e nevojshme leja po që se me marrëveshje ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe.

36.2. Lejet nga paragrafi 1 i këtij Neni i jep Ministri sipas rregullave kritereve dhe procedurave të përshkruara me akt të veçantë juridik.

#### Neni 37

37.1. Gjatë transportit të lirë të udhëtarëve, në autobus duhet pasur flet-udhëtimin lejen në origjinal dhe dokumentet tjera të përcaktuara me Ligj.

37.2. Në qoftë se është fjala për transportin e jashtëm operatori i transportit duhet të ketë edhe listën e udhëtarëve të vërtetuar nga shërbimi doganor i Kosovës.

### 5. TRANSPORTI I UDHËTARËVE ME “TAKSI”

#### Neni 38

38.1. Transporti Taksi është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit sipas çmimoreve të shërbimeve.

38.2. Çmimorja duhet të jetë e vërtetuar nga organi kompetent dhe e vendosur në vend të dukshëm brenda në automjet.

38.3. Taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.

38.4. Transportuesi që kryen transport taksi të udhëtarëve është i obliguar që me kërkesën e udhëtarit, t’i jep atij dëshminë për shërbimin e bërë e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, relacionin, kohën e transportit, çmimin dhe nënshkrimin e transportuesit.

#### Neni 39

39.1. Transportuesi taksi mund të kryhet vetëm me automjet me 5 (4+1) ulëse dhe i cili i ka së paku katër dyer.

39.2. Përgjithësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna mund të licencoj edhe “taksi” me automjete deri në 8+1 ulëse dhe pa taksimetër, mirëpo fushëveprimi i këtij lloji “taksi” kryhet vetëm brenda kufijve territorial të Komunës në të cilën ai është i licencuar.

39.3. Automjeti sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij Neni nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio).

#### Neni 40

Personat që drejtojnë automjetin me të cilin kryhet transporti “taksi” përpos kushteve të

## LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

përcaktuara me akte tjera normative të këtij Ligji dhe ligjeve tjera, duhet të kanë së paku 2 vite përvojë pune në drejtimin e automjetit.

### Neni 41

41.1. Komuna do të nxjerr rregullore të veçantë për mënyrën e kryerjes së transportit të udhëtarëve me “taksi”.

41.2. Me rregullore sipas paragrafit 1 të këtij Neni në veçanti rregullohet:

- a). Mënyrën e organizimit të transportit “taksi” në territorin e Komunës;
- b). Numrin dhe shpërndarjen e stacioneve për taksi, mënyrën e shfrytëzimit të tyre, rregullimin, mirëmbajtjen si dhe numrin e automjeteve në taksi stacionet;
- c). Të drejtat dhe detyrat e drejtuesve të automjeteve taksi si dhe personave që transportohen;
- d). Kushtet themelore dhe plotësuese që duhet plotësuar drejtuesi i taksit dhe automjeti taksi
- e). Numrin e licencave për “taksi” në kuadër të territorit të vetë.

### Neni 42

Drejtuesi i automjetit “taksi” nuk mund të qëndroj e as të marr udhëtarë në territorin e komunës në të cilën nuk është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi.

## 6. TRANSPORTI PËR NEVOJA PERSONALE

### Neni 43

43.1. Operatori transportues, personi tjetër juridik ose fizik dhe qytetari i cili ka automjetin transportues, mund të kryejë transport për nevoja vetjake edhe atë transportin e punëtorëve të vetë ose personave tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vetë, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.

43.2. Transport të udhëtarëve për nevoja personale, në pajtim me këtë Ligj konsiderohet edhe transporti i personave të cilin e bëjnë:

1. Ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtari

hoteliere, si dhe pushimoret që bartin klientët e vetë,

2. Institucionet shëndetësore si dhe të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit,

3. Agjencitë turistike, personat tjerë fizikë dhe juridikë të cilët kryejnë veprimtari turistike ku në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës,

4. Shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera, që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimorë ose anëtarët e vetë,

5. Auto-shkollat të cilët aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre,

6. Operatorët transportues ose punëtorët të cilët kryejnë shërbime të veçanta,

7. Operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit nëse e kryejnë transportin e udhëtarëve nga vendnisja e tyre deri te aeroporti dhe anasjelltas.

### Neni 44

Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja personale duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë i vërtetuar nga ana e pronarit (transportuesit), ose ndonjë dëshmi tjetër për të drejtën e transportit së këtyre punëtorëve ose personave. Në të dy anët, ose në këndin e djathtë të poshtëm të xhamit mbrojtës të autobusit, me të cilët kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, duhet të jetë i shënuar mbishkrimi ”Transporti për nevoja personale”.

### Neni 45

Në kushtet e jashtëzakonshme, Ministria do të nxjerr urdhëresë për transportin e obliguar të udhëtarëve në relacione të caktuara dhe periudhë të caktuar.

## 7. STACIONET E AUTOBUSËVE

### Neni 46

Stacioni i autobusëve është objekti që ka hapësirë për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtarë, gardërobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve, dhe operatorëve të transportit si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët transportues.

### Neni 47

47.1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve bëhet vetëm në stacionet e autobusëve dhe vend ndalimeve të destinuara dhe regjistruara në rendin e udhëtimit.

47.2. Operatori i transportit është i obliguar të ndalet në të gjitha vend ndaljet të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

### Neni 48

48.1. Në varshmëri nga niveli i pajisjes dhe kualitetit të shërbimeve të përgjithshme do bëhet kategorizimi i stacioneve të autobusëve.

48.2. Ministri, me akt të veçantë juridik, do të përcakton kushtet që duhet të plotëson stacioni i autobusëve, mënyrën e punës, kategorizimin, mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit si dhe obligimet tjera të stacionit të autobusëve.

48.3. Stacioni i autobusëve nën kushte të barabarta iu ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues që kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar në Ministri, sipas tarifës të përcaktuar nga Ministria bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.

48.4. Stacionet e autobusëve dhe operatorët e transportit rregullojnë kushtet dhe mënyrën e dhënies së shërbimeve.

48.5. Personat zyrtar të stacionit të autobusëve janë të obliguar që në vend të dukshëm të mbajnë kartelën identifikuese.

### Neni 49

Stacioni i autobusëve nuk guxon të ofrojë shërbime për operatorët e transportit të cilët

nuk kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar nga Ministria nëse është fjala për transport ndër urban, respektivisht leje për transport jashtë Kosove.

### Neni 50

50.1. Stacioni i autobusëve duhet të ketë mbishkrimin "Stacioni i autobusëve" si dhe emërtimin e vendit ku gjendet stacioni.

50.2. Stacioni i autobusëve është i obliguar që të mbajë evidencën mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve.

### Neni 51

51.1. Me fuqizimin e rendit të udhëtimit, stacioni i autobusëve është i obliguar të bëjë sistematizimin e të gjitha rendeve të udhëtimit sipas relacioneve, kohën e nisjes së autobusit nga stacioni i tij.

51.2. Operatori i transportit është i obliguar që të informoj stacionin e autobusëve për fillimin e mbajtjes, pamundësinë e mbajtjes respektivisht për vonesa më të mëdha se 30 minuta.

### Neni 52

Licencën për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të stacionit të autobusëve e lëshon Ministri, po që se stacioni është i destinuar për kryerjen e shërbimeve në transportin ndër urban dhe të jashtëm. Ndërsa për stacione që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit urban licencën e lëshon Komuna.

## KREU III

### TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

### Neni 53

53.1. Transporti rrugor i mallrave (në vijim transporti i mallrave) kryhet brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, si:

- a) Transport i mallrave në llogari të vet (për nevoja personale),
- b) Transport i mallrave me qira dhe pagesë.

### Neni 54

54.2. Gjatë transportit të mallrave operatori në automjet duhet të posedoj këto dokumente:

## LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

a) Për transport brenda Kosovës:

- licencën
- fletëngarkesën.

b) Për transport jashtë Kosovës:

- licencën
- fletëngarkesën dhe
- lejen jashtë Kosovës

### Neni 55

55.1. Transporti i mallrave kryhet në bazë të licencës dhe lejes për transport jashtë Kosovës, në qoftë se nuk është përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare që transporti të kryhet pa leje.

55.2. Ministria përcakton dhe shkëmben numër të nevojshëm lejesh për një vit, me organet kompetente të shteteve tjera.

55.3. Shpërndarjen e lejeve të jashtme për transportuesit vendas e bënë Ministria, ku Ministria e emëron komisionin për shpërndarjen e lejeve jashtë Kosovës.

## LEJET TRANSITE PËR TERRITORIN E KOSOVËS

### Neni 56

56.1. Asnjë transportues i mallrave nuk mund të qarkullojë transit nëpër territorin e Kosovës pa u pajisur me leje transite.

56.2. Ministria do të përshkruan rregullat, procedurat, kriteret për leje transite.

56.3. Tarifën për leje transite do ta përcakton MTPT në bashkëpunim me MEF-in.

### Neni 57

Për shpërndarjen e lejeve të jashtme, transportuesi duhet të paguaj kompensim, lartësinë e kompensimit e përcakton Ministria në bashkëpunim me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 58

Në qoftë se transportuesi i jashtëm është nga shteti me të cilin Kosova nuk ka lidhur kontratë (marrëveshje), atëherë operatorit të transportit me seli jashtë Kosovës i jepet leje e posaçme për hyrje në Kosovë nga Ministria.

### Neni 59

59.1. Nëse operatori i jashtëm bënë transportin e mallrave me automjet tërheqës ose rimorkio me regjistrim në dy shtete të ndryshme, për çdo njërin prej atyre automjeteve duhet të ketë leje nga Neni 58 i këtij Ligji.

59.2. Leja për transportin e mallrave duhet të vërtetohet nga organet doganore, lejen transportuesi duhet ta ketë në automjet gjatë qarkullimit në Kosovë.

### Neni 60

60.1. U ndalohet hyrja në Kosovë të gjithë operatorëve të transportit të mallrave pa leje të posaçme për hyrje në Kosovë, përveç operatorëve transportues të cilët posedojnë lejen e CEMT-it dhe lejen bilaterale.

60.2. Mënyrën dhe kriteret për leje të posaçme për hyrje në Kosovë i përcakton Ministri, nëse me marrëveshje bilaterale nuk është rregulluar ndryshe.

### Neni 61

Lëshimi i lejeve për transportimin e mallrave jashtë dhe brenda Kosovës nga nenet 54, 55, 56, 57, 58 59 dhe 60 të këtij Ligji bëhen në bashkërendim me UNMIK-un.

### Neni 62

Ndërmarrjet publike komunale të themeluara nga njësia lokale e vetëqeverisjes komunale me qëllim të kryerjes së shërbimeve publike komunale nuk do të licencohen.

### Neni 63

63.1. Përgjashtimisht nga dispozitat e nenit 55 paragrafit 1 të këtij Ligji, leje nuk nevojitet,

- Për automjetet me kapacitet bartjeje deri 3.5 tonelata apo në masën më të madhe të lejuar 6 tonelata;
- Për transportin e automjeteve dhe rimorkiove të dëmtuara;
- Për transportin e dërgesave postare,
- Për transportin e eksponateve, të destinuara për panairë dhe ekspozita,
- Për transportin të materialit mjekësor apo materialit tjetër, si ndihma në rast fatkeqësish natyrore dhe lufte,

f) Për hyrje të automjetit të zbrazët për ndërrim automjeti defekt dhe marrje të sendeve përsipër për transportim nga automjeti defekt,  
 g) Për automjete të ndihmës teknike për tërheqje të automjeteve defekte (automjeteve serviso-riparuese),  
 h) Për automjetet që vijnë për servisim apo ndreqje në Kosovë, me kusht që të jenë të zbrazëta,

63.2. Për transportin nga paragrafi 1 i këtij Neni, operatori i transportit duhet të ketë shkresat dhe dokumentacionin tjetër nga i cili mund të konstatohet se është fjala për transportin nga paragrafi 1 i këtij Neni.

## 1. TRANSPORTI I MALLRAVE PËR NEVOJA PERSONALE

### Neni 64

64.1. Ndalohet marrja me transport për nevoja personale pa qenë i regjistruar si një transportues për nevoja personale.

64.2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen mbi mbajtësin e një licence për transport rrugor të mallrave me qira.

64.3. Ministri mund të liroj lloje të transportit të mallrave në llogari të vet nga ndalesa që referohet në paragrafin 1.

### Neni 65

65.1. Emri dhe natyra e ndërmarrjes ose biznesit duhet të deklarohet kur veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja personale të regjistrohet.

65.2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregon që transporti i mallrave për të cilën regjistrimi është kërkuar mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja personale.

### Neni 66

Më rastin e kryerjes së transportit për nevoja personale, me automjet mbi 3.5 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të ketë:

a) fletëngarkesën dhe  
 b) dëshminë nga e cila mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja personale.

## 2. TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PAGESË

### Neni 67

67.1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë kryhet në bazë të kontratës në mes të qiradhënësit të automjetit transportues dhe qiramarrësit i cili kontraktin transportin e mallrave.

67.2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë operatori i transportit në automjetin bartës duhet të ketë:

a) Fletëngarkesën dhe  
 b) Kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

3. Terminalët e mallrave (Stacionet e ngarkesave)

### Neni 68

68.1. Shërbimet e terminaleve të mallrave në pajtim me këtë Ligj, janë pranimi dhe nisja e automjeteve të mallrave, të shërbyerit të automjeteve dhe anëtarëve të ekuipazhit, deponimi i mallrave dhe shërbimet tjera të kontraktuara në lidhje me transportin e mallrave.

68.2. Terminali i mallrave ka për detyrë t'ju ofrojë shërbime, me kushte të njëjta të gjithë transportuesve.

68.3. Për të filluar kryerjen e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve të Terminalit, nga Neni 14 paragrafi 2 i këtij Ligji, jepet licenca.

### Neni 69

Ministria do të nxjerr urdhëresa për ndalimin e transportit të mallrave nëpër rrugët e Kosovës për rrugë të caktuara, lloje të caktuara dhe periudhë të caktuar.

LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

**Neni 70**

Terminali duhet të jetë i pajisur dhe i aftësuar për pranim, nisje dhe doganim të të gjitha llojeve të mallrave.

**KREU IV**

**MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI NË  
TRANSPORTIN RRUGOR**

**Neni 71**

Mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi zbatimin e këtij Ligji e të akteve tjera juridike të nxjerra mbi bazë të tij, e bën Ministria e Transportit dhe Postë telekomunikacionit (organi i inspektoratit të Ministrisë).

**Neni 72**

72.1. Punët e inspektimit në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave i kryejnë inspektorët e transportit rrugor të Ministrisë, ndërsa për transportin rrugor urban dhe transportin auto taksi brenda territorit të komunës i bënë inspektori i transportit rrugor komunal.

72.2. Inspektorët e transportit rrugor janë të detyruar që kontrollin ta kryejnë në pajtim me dispozitat e këtij Ligji si vijon:

- a) Inspektimin dhe kontrollimin e operatorëve të transportit rrugor, a janë duke e ushtruar veprimtarinë e vet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe a e ushtrojnë atë në bazë të licencave dhe lejeve.
- b) inspekton dhe kontrollon të gjitha automjetet e transportit rrugor, stacionet e autobusëve, objektet tjera afariste, dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor;
- c) kujdeset për organizimin dhe mbarëvajtjen e rregullt të transportit rrugor të brendshëm dhe të jashtëm në tërë territorin e Kosovës.

**Neni 73**

Operatori i transportit rrugor është i detyruar t'i paraqesë inspektorit gjithë dokumentet e kërkuara dhe t'i krijojë atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas këtij Ligji.

**Neni 74**

Organi i inspektoratit të Ministrisë bënë mbikëqyrjen mbi bazë të programit vjetor të punës, të cilin e nxjerrë Ministri, e sipas nevojës edhe jashtë programit.

**Neni 75**

75.1. Në qoftë se inspektori i transportit rrugor, gjatë inspektimit konstaton parregullsi, përkatësisht konstaton së transporti nuk është duke u kryer në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, dispozitat e këtij Ligji apo akteve tjera ligjore të nxjerra në bazë të këtij Ligji, do të përjashtojë automjetin nga qarkullimi, duke i marrë lejen e qarkullimit e sipas nevojës edhe targat e qarkullimit në kohëzgjatje prej 48 orësh.

75.2. Në qoftë se inspektori shqipton masën e dënimit të njëjtit operator për herë të dytë për shkaqet e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij Neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në pesë ditë.

75.3. Me rastin e përjashtimit të automjetit auto taksi, merret shenja taksi dhe numri i evidencës i regjistrimit të qarkullimit.

75.4. Me kalimin e afatit të shqiptimit të dënimit nga paragrafi 1 e 2 i këtij neni, inspektori i kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra qoftë vetë apo përmes organit i cili i ka dhënë këto.

**Neni 76**

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet në shpenzime të mbajtësit të licencës në vende të caktuara për këto raste. Nëse është e domosdoshme lidhur me këtë mund të kërkohet ndihma e policisë.

**Neni 77**

77.1. Me rastin e ndalimit përkatësisht përjashtimit të automjetit nga qarkullimi, inspektori përgatitë një raport zyrtar lidhur me këtë dhe brenda 24 orësh për këtë ,me shkrim do ta njoftoi Ministrinë.

77.2. Një kopje të raportit zyrtar do t'i jepet drejtuesit të automjetit përkatësisht mbajtësit



të licencës ose mbajtësit të regjistrimit të automjetit.

77.3. Po që se inspektori konstaton së operatori i transportit rrugor ka bërë shkelje të dispozitave të këtij Ligji, do të iniciojë procedurë gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

#### **Neni 78**

Për eliminimin e parregullsive në transportin rrugor, inspekcioni i transportit, sipas nevojës, bashkëpunon me Shërbimin Policor të Kosovës dhe në koordinim ndërmarrin masat përkatëse, sipas kompetencave që kanë.

#### **Neni 79**

Organet e kontrollit të shërbimit doganor në vendkalimet kufitare, përkatësisht në vend tjetër, ku bëhet mbikëqyrja doganore, kontrollojnë së transportuesi i jashtëm apo vendës a ka leje dhe dokumente tjera, të përcaktuara me këtë Ligj, apo me marrëveshjet ndërkombëtare dhe a bën transportimin në pajtim me ato dokumente.

#### **Neni 80**

Në qoftë se organet e kontrollit të shërbimit doganor konstatojnë së transportuesi i jashtëm apo vendës, nuk ka në automjet lejen, të përcaktuar me rregull dhe dokumente tjera të nevojshme apo nuk i shfrytëzon në mënyrë të përcaktuar, do të ndalojë hyrjen e automjetit në Kosovë apo daljen prej saj dhe për këtë do ta informon Ministrinë.

#### **Neni 81**

Përgjegjësitë që duhet të zbatohen nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes sipas nenit 79 dhe 80 e të cilat përfshijnë edhe Shërbimin e Doganave të UNMIK-ut ushtrohen vetëm nëpërmjet ose në bashkërendim me UNMIK-un.

#### **Neni 82**

82.1. Ministria, organeve të kontrollit të kalimit kufitar u bën të njohura modelet e dokumenteve me të cilat duhet të jenë të pajisura mjetet e transportit të jashtëm dhe përparësitë e kalimit të tyre.

82.2. Gjuha e dokumenteve përcaktohet në

marrëveshjet në mes të Kosovës dhe vendeve tjera, të nënshkruara në emër të Kosovës.

## **KREU V SANKSIONET ADMINISTRATIVE**

### **Neni 83**

83.1. Operatori i transportit përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik për kundërvajtje do të ndëshkohet me gjobë prej 300 deri në 3.500 €, në qoftë se:

- a) Ushtron veprimtarinë e transportit publik urban dhe ndër urban pa licencë (Neni 11 paragrafi 1.)
- b) Ushtron veprimtarinë e transportit të jashtëm pa licencë dhe leje përkatëse (Neni 11 paragrafi 3, Neni 14 paragrafi 1, dhe neni 55 paragrafi 1).
- c) Bënë transportin taksi në kundërshtim me dispozitat e nenit 38.
- d) Ofron shërbime të stacionit të autobusëve dhe terminale të mallrave (stacioneve të ngarkesave) pa licencë ( Neni 55 dhe Neni 74 ).
- e) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 2.
- f) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 60 paragrafi 1.
- g) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 73.

83.2. Po që se operatori i transportit përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bën përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, përveç dënimit me gjobë do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje 6 deri në 12 muaj.

### **Neni 84**

84.1. Me gjobë prej 100 deri në 2.500 € do të ndëshkohet operatori i transportit përkatësisht personi tjetër juridik, në qoftë se:

- a) Nuk mban linjën në pajtim me rendin e vërtetuar të udhëtimit (Neni 24 paragrafi 1).
- b) Ndryshon rendin e udhëtimit, ndërprejë përkohësisht transportin dhe nuk e paraqet ndërprerjen ( Neni 25 paragrafi 3 dhe 4 ) dhe Neni 28 paragrafi 2).

LIGJI PËR TRANSPORTIN RRUGOR

- c) Nëse nuk përcakton çmimoren dhe nuk e vendos në autobus apo nuk i përmbahet asaj ( Neni 28).
- d) Benë transportimin e veçantë të udhëtarëve në kundërshtim me nenin 30.
- e) Nuk ka në automjet fletë udhëtimit (Neni 37 paragrafi 1 ).
- f) Në qoftë së nuk e ka listën e udhëtarëve të vërtetuar nga shërbimi doganor i Kosovës (Neni 37 paragrafi 2).
- g) Benë transportin taksi të udhëtarëve në kundërshtim me nenet 38-42.
- h) Benë transport për nevoja personale në kundërshtim me nenet 42 dhe 43.
- i) Në qoftë së stacioni i autobusëve dhe terminali i mallrave (stacioni i ngarkesave) ofrojnë shërbime pa licencë dhe rend udhëtimit (Neni 52 dhe Neni 68 paragrafi 3)
- j) Stacioni i autobusëve apo terminali i mallrave (stacioni i ngarkesave) nuk u ofron shërbime me kushte të njëjta të gjithë transportuesve ( Neni 48 paragrafi 3 dhe Neni 68 paragrafi 2).
- k) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 1 dhe 3.
- l) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 29 paragrafi 1 dhe 2.
- m) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1.
- n) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 35 paragrafi 1.
- o) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 44.
- p) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 dhe 2.
- q) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 64 paragrafi 1.
- r) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 66 dhe 67.
- s) Nëse vepron në kundërshtim me nenin 5.1 nën b, c, d, e, f.

84.2. Për kundërvajtje të njëjta që transportuesi përkatësisht personi juridik apo fizik ,i përsëritë përveç dënimit me gjobë do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

## KREU VI

### DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 85

Të ardhurat e krijuara nga tarifat e mbledhura dhe dënimet e vendosura sipas këtij Ligji, derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

#### Neni 86

Ministria për implementimin e dispozitave të këtij ligji nxjerrë akte përkatëse nënligjore.

#### Neni 87

Procedurat e filluara sipas dispozitave të ligjit mbi transportin në komunikacionin rrugor (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 5/82) do të përfundojnë sipas dispozitave të ligjit të aplikueshëm.

#### Neni 88

Operatorët e transportit rrugor të cilët ushtrojnë këtë veprimtari, janë të obliguar që afarizmin e vetë ta harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji dhe aktet tjera të nxjerra në bazë të tij brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

#### Neni 89

Operatorët e transportit rrugor të cilët nuk e harmonizojnë afarizmin e vetë brenda afatit të përcaktuar sipas dispozitave të nenit 88 , pushojnë së kryeri veprimtarinë e transportit rrugor, e këtë do ta përcaktojë me vendim organi kompetent.

#### Neni 90

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji mbi transportin në komunikacionin rrugor (Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 5/82)

#### Neni 91

Ky Ligj hyn në fuqi pasi të miratohet nga Kuvendi dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja.

Më 9 maj 2005  
UNMIK/REG/2005/23